

GJENDJA DHE CILËSIA E MËSIMIT NË SHKOLLAT E VOGLA DHE NË PARALELET E NDARA

në kontekstin e organizimit të tanishëm
të rrjetit të shkollave në Kosovë

Prishtinë, gusht 2023



GJENDJA DHE CILËSIA E MËSIMIT NË SHKOLLAT E VOGLA DHE NË PARALELET E NDARA

në kontekstin e organizimit të tanishëm
të rrjetit të shkollave në Kosovë

Prishtinë, gusht 2023

Autor: Xhavit Rexhaj

Redaktore gjuhesore: Afrore Lila

Design: Envinion

Publikuar nga:

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Kompleksi i Shkollës "Mileniumi i Tretë"
rr. "Qëndresa" nr. 48, Matiçan,
10000 Prishtinë, Kosovë
www.kec-ks.org
office@kec-ks.org

Shënim: Ky hulumtim është pjesë e projektit "Përkrahja e arsimit të lartë përmes avokimit dhe kontributit të bazuar në hulumtim" i mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të autorit dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS.

Përmbajtja

Shkurtesat	7
Termet:.....	8
Përmbledhje ekzekutive.....	9
Hyrje:.....	11
Financimi dhe vendimmarrja në arsimin parauniversitar:.....	16
Analizë e trendëve demografikë e financiarë në arsimin parauniversitar në Kosovë në 10 vitet e fundit	17
Metodologjia e hulumtimit	23
Politikat kryesore dhe korniza ligjore	25
Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës	26
Korniza për sigurim të cilësisë të performancës së institucioneve arsimore	28
Udhëzimi MASHT Nr. 4/2017 për vlerësimin e performancës së IAAPU	30
Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës 03/L-068	30
Udhëzimi Administrativ (MASHTI UA Nr. 10/2023) për kriteret dhe procedurat për themelimin dhe pushimin e veprimtarisë së shkollës.....	31
Prezantim dhe diskutim i rezultateve të hulumtimit	33
Rezultatet e intervistave:	34
Drejtoritë komunale të arsimit – drejtorët dhe zyrtarët	34
Drejtorët e shkollave	36
Mësimdhënësit në mes të kauzës socio-kulturore dhe asaj arsimore.....	36
Punëtorët e mirëmbajtjes:.....	37
Prindërit:.....	38
Prezantim i rezultateve nga bisedat me prindërit	38
Nxënësit.....	42
Identifikimi i çështjeve kryesore (kategoritë)	47
Zbatimi i mangët i dispozitave ligjore	48
Dimensionet e rrezikuara	49
Gjetje të tjera nga intervistat.....	50

Praktikat e mira:	53
Praktikat e mira jashtë vendit	54
Modeli i planifikimit të rrjetit shkollor nga Unicef	55
Praktikat e mira në Kosovë:	57
 Konkluzionet dhe rekomandimet:	 59
Konkluzionet:	60
Rekomandimet.....	61
Nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kërkohet:.....	61
Drejtoritë Komunale të Arsimit – Komunitet	62
Drejtorët e shkollave:	63
 Vështirësitë e hulumtimit:	 64
 Bibliografia	 65

Shkurtesat

APU Arsimi parauniversitar

DKA Drejtoria Komunale e Arsimit

KASH Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

KEC Qendra Arsimore Kosovare

MASHTI Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

MF Ministria e Financave

OECD Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim

PN Paralelet e Ndara

ShF Shkolla Fillore

ShMU Shkolla e Mesme e Ulët

ShML Shkolla e Mesme e Lartë

ShV Shkollat e Vogla

UNESCO Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

Termat:

Konsolidimi i rrjetit të shkollave – Masat që mund të marrin MASHTI ose drejtoritë komunale të arsimit me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve arsimore në shkollat e vogla dhe funksionimin më efikas të rrjetit të shkollave. Ky term përdoret në këtë raport në kuptimin e bashkimit, bashkëpunimit më të ngushtë dhe të ristrukturimit të menaxhimit të një e më shumë shkollave në një zonë, që të sigurohet rritja e efikasitetit përmes ekonomisë së shkallës dhe menaxhimit më të mirë të shkollave. Po ashtu, ky term përdoret që të shmanget përdorimi i termave shuarje, mbyllje dhe shkrirje e shkollave, të cilat nuk e pasqyrojnë kompleksitetin e situatës dhe të zgjidhjeve të mundshme. Qëllimi është që të kuptohet se prioritet i autoriteteve arsimore janë cilësia, qëndrueshmëria dhe funksionimi më i mirë i sistemit arsimor – jo masat administrative me qëllim përfundimtar si kursimet buxhetore.

Rrjeti i shkollave – tërësia e institucioneve dhe e objekteve shkollore përmes të cilave sigurohen shërbimet arsimore në një sistem arsimor.

Qeverisja – kush i sjell, zbaton dhe monitoron vendimet që ndikojnë në organizimin e rrjetit të shkollave, si dhe baza politike e ligjore mbi të cilën merren këto vendime.

Ekonomia e shkallës – term ekonomik që nënkupton me rritjen e sasisë së prodhimit nga ana e kompanive ulen kostot e prodhimit për njësi të prodhuar. E përkthyer në rrethanat e funksionimit të shkollave, kjo mund të përkthehet në koston më të vogël të funksionimit të shkollave më të mëdha llogaritur për njësi (numër të nxënësve), pasi që një sërë shpenzimesh (komunale, interneti, ngrohja, mirëmbajtja, mjetet materiale) mbesin përafërsisht të njëjta (McGee 2014).

Përmbledhje ekzekutive

Parimet dhe parakushtet kryesore për organizimin dhe (ri)strukturimin e një rrjeti efikas dhe efektiv të shkollave në nivelin parauniversitar janë udhëheqja e qartë dhe përkushtimi, qasja sistematike dhe e planifikuar, ekzistimi i kapaciteteve dhe i ekspertizës në nivelet përkatëse të autoriteteve arsimore, pjesëmarrja aktive dhe konsultimet me palët kryesore, dhe synimi i vazhdueshëm për sigurimin e cilësisë së shërbimeve arsimore.

Në këtë studim është analizuar gjendja e tanishme në rrjetin e shkollave në Kosovë dhe janë vlerësuar gjendja, veprimet, dhe qëndrimet e faktorëve kryesorë krahasuar me parimet e parakushtet e domosdoshme për ekzistimin dhe krijimin e një rrjeti funksional shkollor.

Të gjeturat kryesore të hulumtimit, i cili i ka paraprirë këtij studimi tregojnë se duhet ndërruar qasjen në organizimin e rrjetit shkollor nëse synojmë sigurimin e shërbimeve cilësore arsimore, dhe zhvillimin e fëmijëve në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Në vijim prezantohen shkurt të gjeturat kryesore të hulumtimit lidhur me gjendjen e mësimit në shkollat e vogla dhe në paralelet e ndara në arsimin parauniversitar¹ në Kosovë:

- Gjendja lidhur me kushtet e punës dhe me cilësinë e shërbimeve arsimore në shkolla të vogla (ShV) dhe në paralele të ndara (PN) është më e rëndë se që mendohet zakonisht.
- Me ndonjë përjashtim, Komunat nuk kanë kapacitetin, resurset dhe as ekspertizën e duhur për konsolidimin e rrjetit të shkollave. Kjo vërtetohet me ekzistimin e shkollave të vogla jashtë parametrave të lejuara në UA 104/2020 dhe me realizimin e mësimit në klasë të kombinuara.
- Komunat deklarohen të angazhuara që të zbatojnë udhëzimin e tanishëm të MASHTI për shkollat e vogla (104/2020), mirëpo (me ndonjë përjashtim të rrallë) nuk ka ndonjë qasje sistematike dhe të planifikuar për zbatimin e tij. Arsyetimet kryesore lidhen me reagimin e komunitetit, por nuk vërehen përpjekje të përkushtuara për adresimin e çështjeve.
- Komunat nuk kanë rregullore të mirëfillta për organizim cilësor të transportit të nxënësve në territorin e komunës. Aktualisht, për mbikëqyrjen e cilësisë së transportit të nxënësve, inspektorati dhe policia rrugore mbështeten në kushtet e shpallura në thirrjet për furnizim me shërbime transportuese. Mirëpo, këto rregulla janë kryesisht kushte teknike, që nuk parashohin sa duhet mbrojtjen e sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve. MASHTI duhet të ndihmojë me vendosjen e një standardi në shkallë vendi.

¹ Në bazë të studimit të literaturës, si dhe intervistave e vizitave të kryera në 12 shkolla në gjashtë komuna të Kosovës.

- Përkundër përkushtimit të mësimdhënësve dhe të nxënësve në shkollat e vogla e në paralelet e ndara, nxënësit nuk përfitojnë as për së afërmi shërbime cilësore edukative e arsimore.
- Në disa shkolla të vogla dhe paralele të ndara me më pak nxënës - **vazhdon të zbatohet mësimi i kombinuar!**
- Brengos tendenca e qartë e lënies totale pas dore të personelit dhe të nxënësve që punojnë dhe mësojnë në shkolla të vogla/ paralele të ndara. Te mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të vogla dhe të paraleleve të ndara vërehet pasiguria për fatin e shkollës, mungesa e gjallërisë së mjedisit mësimor, mungesa e zhurmës në oborr gjatë pushimeve, mungesa e aktiviteteve sportive e të tjera. Kjo ndikon dukshëm në zhvillimin dhe në formimin e fëmijëve. Mungesa e pajisjeve teknologjike vetëm sa e shton këtë atmosferë të ndrydhur. Shkollat e vogla funksionojnë në një realitet tjetër – pa optimizëm e gjallëri të fëmijëve.
- Në shkollat e vogla ka një ndërprerje të plotë të investimeve me pajisje, mjete materiale, e ndonjëherë edhe në renovime.²
- Problemi i fshehur: Një shkollë me 70 nxënës që zhvillon mësimin në klasën parafillore dhe në nëntë klasë (0 - 9) nuk është në gjendje më të mirë se një shkollë me 20 nxënës që zhvillon mësimin në katër klasë (1-4). Përkundrazi, sa më shumë nxënës në shkollat e vogla (për shembull deri në 100 nxënës) aq më i madh numri i fëmijëve të dëmtuar nga mungesa e arsimit, edukimit dhe socializimit cilësor. Edhe pse në suaza të ligjit (kriteri i numrit për shkolla të vogla në UA 104/2020), këto institucione gjithashtu i shkelin kriteret minimale për sigurimin e cilësisë dhe për mirëqenien e fëmijëve.

Rekomandohet bashkëpunim dhe bashkërenditje më e mirë e përpjekjeve në mes të autoriteteve arsimore të nivelit qendror dhe komunal për qëllim të sigurimit të një qasjeje më sistematike për konsolidimin e rrjetit të shkollave dhe për përmirësimin e shërbimeve arsimore në shkollat e vogla dhe në paralelet e ndara.

2 Në një komunë objekti i shkollës së vogël ishte aq i vjetër dhe i rrënuar sa që nuk kishte efekt të bëheshin renovime të vogla; njëkohësisht, intervenimet e mëdha nuk mund të bëheshin për shkak të numrit të vogël të nxënësve.

Hyrje

1

Në 10 vitet e fundit në arsimin kosovar ka pasur një trend të theksuar të rënies së numrit të nxënësve në arsimin parauniversitar. Një trend i tillë ka ardhur si rezultat i lëvizjes së popullatës dhe të fëmijëve që kanë vijuar shkollimin nga zonat rurale në zona urbane, migrimit të njerëzve kah vendet e Evropës perëndimore, si dhe për shkak të rënies së përgjithshme të shtimit demografik të popullatës (prej rreth 30 promil në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar në 11 promil në vitin 2022).³ Trendi i rënies së numrit të nxënësve në Kosovë është mesatarisht rreth 3 % e numrit të përgjithshëm të nxënësve më pak për secilin vit gjatë dhjetë viteve të fundit.⁴ Për ilustrim, në vitin shkollor 2012/13 në arsimin parauniversitar në Kosovë kanë qenë gjithsej rreth 421,277 fëmijë/nxënës të përfshirë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar (mosha 1-5 dhe klasat 0-12), ndërkaj në vitin shkollor 2022/23 ky numër ka rënë në 300,362 fëmijë/ nxënës (Agjencia e Statistikave e Kosovës 2023). Domethënë, gjatë dekadës së fundit në arsimin kosovar numri i nxënësve ka rënë për 120,000 nxënës ose në përqindje rreth 30 % më pak nxënës krahasuar me vitin 2013.

Trendi i përgjithshëm i rënies së numrit të nxënësve në sistemin arsimor nuk është karakteristik vetëm për Kosovën. Sipas një studimi të OECD-së, edhe vendet anëtare të kësaj organizate janë duke kaluar nëpër zhvillime të ngjashme: *“Zhvillimet demografike, përfshirë migrimin rajonal e ndërkombëtar dhe rënien e vazhdueshme të numrit të lindjeve, janë një faktor i rëndësishëm në ndryshimin e nevojave dhe kërkesave arsimore që ndikon në organizimin efikas të shërbimeve nga sistemet arsimore në vendet e OECD-së. Në kuadër të trendit të përgjithshëm të tkurrjes së popullatës shkollore, ka dallime të konsiderueshme në mes të vendeve të ndryshme, por edhe në mes të rajoneve brenda vendit të njëjtë”* (Responsive School Systems: Connecting Facilities, Sectors and Programmes for Student Success 2018).

Ngjashëm me vendet e OECD-së, rënia e numrit të nxënësve në tërë Kosovën ka një shpërndarje të pabarabartë, ashtu që në zonat rurale është dukshëm më e madhe se ritmi i rënies në zonat urbane. Madje në disa zona urbane (për shembull Fushë Kosova dhe Prishtina) ka një trend të rritjes së numrit të nxënësve – popullatës arsimore – për dallim prej trendit të përgjithshëm negativ në Kosovë në shtimin e popullsisë dhe migrimit të popullatës kah vendet perëndimore.

Në vitin 2022 MASHTI ka themeluar një grup punues⁵ për analizën e gjendjes dhe hartimin e një plani për riorganizimin e rrjetit shkollor në arsimin parauniversitar në Kosovë. Në përkrahje të punës së këtij grupi punues, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) ka mundësuar kryerjen e një hulumtimi për hartimin e këtij raporti që të ndihmojë autoritetet arsimore në hartimin dhe zbatimin e një qasjeje më sistematike në rregullimin e rrjetit shkollor në Kosovë, duke ndërtuar mbi praktikën e mira, në vend dhe jashtë.

3 Në bazë të të dhënave të Bankës Botërore. World Bank Open Data. <https://data.worldbank.org/indicator/SP.DYN.CBRT.IN?locations=XK> hapur në gusht 2023

4 Sipas të dhënave të Entit Statistikor të Kosovës dhe të Shënimeve statistikore të MASHTI.

5 Vendim i MASHTI numër 2/1034, 16.05.2022, për themelimin e grupit punues për Analizën e gjendjes së rrjetit shkollor në Kosovë dhe për hartimin e planit për riorganizimin e rrjetit shkollor.

Qëllimi:

Qëllimi i këtij studimi është që t'i kontribuojë rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së organizimit të mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë duke analizuar dhe identifikuar përparësitë dhe dobësitë e (i) organizimit të rrjetit shkollor dhe (ii) të mësimi në shkollat e vogla (ShV) dhe në paralelet e ndara (PN) në Kosovë. Po ashtu, përmes këtij studimi synohet të sigurohet një udhërrëfyes për konsolidimin e rrjetit të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar.

Objektivat:

Është analizuar dhe krahasuar efikasiteti i organizimit të mësimi në shkollat e vogla dhe në shkollat më të mëdha urbane.

Janë shqyrtuar përfitimet dhe sfidat e nxënësve nga organizimi i mësimi në shkolla të vogla/ paralele të ndara,

Është vlerësuar gjendja në shkollat e vogla/ paralelet e ndara.

Janë shqyrtuar praktikatat e mira në rajon dhe në botë në fushën e rregullimit të rrjetit të shkollave.

Pyetjet kërkimore:

- Sa është efikas dhe i arsyeshëm organizimi i mësimi në shkollat e vogla/ paralelet e ndara?
- Cili është mendimi i komunitetit lidhur me ekzistimin e ShV/ PN në komunitetin e tyre?
- Cilat janë praktikatat e mira jashtë vendit për organizimin e rrjetit të shkollave?
- A ka alternativa më të mira krahasuar me organizimin e tanishëm të rrjetit të shkollave në Kosovë?

Gjendja e tanishme

Nga këndvështrimi i numrit të institucioneve arsimore, gjatë kësaj dekade Kosova ka shënuar rënie të numrit të shkollave/ institucioneve arsimore prej 1174 në vitin 2013 (Agjencia e Statistikave e Kosoves 2013) në 1044 institucione arsimore në vitin 2023 (Agjencia e Statistikave e Kosoves 2023). Rënia e përgjithshme e numrit të shkollave (prej rreth 130) duket të jetë reflektim i shuarjes së paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla për arsye se gjatë kësaj periudhe dhjetëvjeçare është shënuar një trend (rreth 31.5 %) i rënies së numrit të paraleleve të ndara fizike prej 386 PN në vitin 2013 në 265 PN në vitin 2023.

Në bazë të këtyre të dhënave të paraqitura më lart, në dhjetë vitet e fundit, numri i përgjithshëm i institucioneve shkollore ka pësuar rënie të lehtë (rreth 9 %), numri i nxënësve ka pësuar rënie prej rreth 30 %, ngjashëm me numrin e paraleleve të ndara që ka shënuar rënie prej 31.5 %. Gjatë së njëjtës periudhë, numri i shkollave amë ka qëndruar relativisht stabil duke shënuar rënie të lehtë prej 788 në vitin 2013 në gjithsej 779 shkolle amë në vitin 2023. Domethënë, rënia e konsiderueshme e numrit të nxënësve përputhet përafërsisht me përqindjen e shënuar të rënies së numrit (121) të paraleleve të ndara, ndërkaq numri i shkollave amë ka një dallim të vogël me një rënie prej vetëm 9 shkollash në këtë periudhë. Këtu mund të lexohet një trend i shuarjes graduale të shkollave të vogla amë dhe të paraleleve të ndara në zonat rurale, dhe një ruajtje ose rritje e vogël e numrit të shkollave amë në zonat urbane.

Trendi demografik në arsim, përfshirë rënien e numrit të nxënësve për paralele (prej 23.8 për paralele në vitin 2013 në 17.3 në arsimin fillor e të mesëm të ulët dhe 20.6 në arsimin e mesëm të lartë në vitin 2023)⁶, dhe rënien e proporcionit nxënës/ mësimdhënës (prej rreth 19/1 në vitin 2013 në rreth 13/1 në vitin 2023) tregojnë për një rënie të dukshme të efikasitetit të organizimit të institucioneve arsimore dhe të mësimit në Kosovë në 10 vitet e fundit. Ky trend, ka rezultuar me numër të lartë të mësimdhënësve kundrejt numrit të nxënësve gjithnjë në rënie. Nuk duhet harruar se në raportin nxënës – mësimdhënës në Kosovë, pos trendit demografik, ka ndikuar edhe planifikimi i mangët i reformave arsimore. Kështu, futja në sistem e klasës së nëntë (viti 2002) dhe shuarja e klasës së trembëdhjetë (2014) kanë ndikuar në rritjen e numrit të mësimdhënësve në sistem.

Mirëpo, Kosova nuk është e vetme në këtë trend. Sipas një studimi të OECD-së (OECD 2019), vende të ndryshme (sikurse Kosova dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, vërejtje e autorit) aktualisht përballen me problemin e ruajtjes së numrit të mësimdhënësve në sistem në rrethana të rënies së numrit të nxënësve (p.sh. Lituania) ose me numrin e lartë të të diplomuarve nga institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve (fakultetet e Edukimit). Megjithatë, mungesa e numrit të nxënësve dhe furnizimi i tepërt (me mësimdhënës) zakonisht, jo vetëm që shkojnë në cikle (me rënie dhe ngritje), por edhe bashkekzistojnë, pasi që mësimdhënësit janë të shpërndarë në mënyrë të pabarabartë nëpër lëndë dhe zona gjeografike. Sot, njëkohësisht me zbrazjen e popullatës nga zonat e largëta rurale, në Kosovë vërejmë zona urbane të mbingarkuara me nxënës (Prishtinë, Fushë Kosovë, Ferizaj) në të cilat raporti nxënës – mësimdhënës është shpesh më i lartë se ai i përcaktuar në dispozitat ligjore. Po njëjtë, sipas studimit të sipërpërmendur të OECD-së, edhe kur ka tepërcë të numrit të mësimdhënësve, shpesh ka mungesa për lëndë specifike (p.sh. matematikë ose shkenca natyrore), specializime (p.sh. nevoja të veçanta) dhe vendndodhje (p.sh. në zonat urbane ose në lagjet urbane të pa favorizuara). Rrjedhimisht, Kosova duhet të merret me çështjen e shpopullimit ose mbi-popullimit në mënyrë specifike dhe sipas natyrës së problemeve dhe trendëve demografikë.

6 Krahazo me mesataren e vendeve të OECD-së për arsimin fillor (21 nxënës për paralele) dhe për arsimin e mesëm të ulët prej 23.5 nxënës për paralele. Burimi: <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/9789264306707-en.pdf>

Në bazë të këtyre të dhënave të paraqitura më lart, në dhjetë vitet e fundit, numri i përgjithshëm i institucioneve shkollore ka pësuar rënie të lehtë



rreth 9%

numri i nxënësve ka pësuar rënie prej rreth

30%

ngjashëm me numrin e paraleleve të ndara që ka shënuar rënie prej

31.5%

Gjatë së njëjtës periudhë, numri i shkollave amë ka qëndruar relativisht stabil duke shënuar rënie të lehtë prej

në gjithsej

788

në vitin 2013

779


shkolla amë në vitin 2023.

Duket se ndërtimet intensive të objekteve shkollore (shpesh pa ndonjë koncept dhe plan të qëndrueshëm) dhe shtrirja e rrjetit të shkollave pas luftës (në periudhën 2000 – 2010) nuk i kanë marrë parasysh projeksionet e trendëve demografikë. Një qasje e tillë nuk ka sjellë përmirësim të cilësisë në arsim, por vetëm rritje të kostos për shërbimet arsimore. Kostoja e rritur e shërbimeve arsimore (numri i njëjtë i shkollave dhe mësimdhënësve për numrin dukshëm më të vogël të nxënësve) reflektohet drejtpërsëdrejti në cilësinë e shërbimeve arsimore për shkak të imponimit tashmë për përqendrimin e investimit të fondeve të rezervuara për arsim në infrastrukturën shkollore dhe në paga të personelit arsimor. Kur kësaj i shtohet trendi në rënie për cilësinë e arsimit (shih rezultatet e testit PISA 2015 – 2018 dhe gjetjet në vijim të këtij hulumtimi), atëherë konkludohet se Kosova duhet të rishikojë seriozisht rrjetin e shkollave në arsimin parauniversitar.

Zhvillimet e këtilla kanë rezultuar me ulje të efikasitetit të arsimit parauniversitar në Kosovë, por edhe me fenomene çrregulluese me pasoja të rënda për mirëvajtjen e procesit arsimor, siç ishte rasti me mosvijimin e mësimi nga disa qindra nxënës në komunën e Kamenicës në vitet 2020-2021. Çështja e rrjetit të shkollave në Kosovë është një ndër prioritetet e MASH-TI-t edhe këtë vit. MASHTI, më herët (2022) ka themeluar një grup punues për hartimin e një politike dhe akteve përkatëse normative për rregullimin e çështjes së rrjetit të shkollave, me fokus në shkollat e vogla dhe në paralelet e ndara në Kosovë. Ky raport shërben që të ndihmohen MASHTI dhe komunat në sjelljen e vendimeve sa më të informuara për konsolidimin e rrjetit të shkollave në vitet në vijim.

Financimi dhe vendimmarrja në arsimin parauniversitar:

Arsimi parauniversitar në Kosovë financohet pothuajse kryekëput nga buxheti qendror i Kosovës. Bartja e fondeve prej buxhetit qendror në komuna bëhet nëpërmjet të grantit specifik për arsim. Ky grant mbulon pagat, shërbimet dhe mallrat dhe investimet kapitale.⁷ Në bazë të të dhënave të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për vitin 2024-2026, granti specifik (për komunat e Kosovës) për arsim parauniversitar për vitin 2024 do të jetë në shumën prej 238.5 milion euro si në vijim të ndara sipas kategorive në vijim:⁸



Njëkohësisht, korniza ligjore në fuqi (shih në vijim seksionin e kornizës ligjore) përcakton se komunat kanë përgjegjësi ekskluzive për organizimin dhe menaxhimin e arsimit në nivel vendor. Domethënë, shumica e fondeve për arsim sigurohen nga buxheti qendror, ndërsa vendimmarrja në arsim, përfshirë punësimin e personelit dhe rregullimin e rrjetit të shkollave, u takon komunave. Një rregullim i tillë pos tjerash ka rezultuar në parregullsi të konsiderueshme sa i përket punësimit të personelit dhe ndërtimit/ hapjes së shkollave të reja. Punësimi i personelit dhe ndërtimi i shkollave në nivel komunal është bërë në masë të madhe pa një planifikim dhe studim paraprak të mirëfilltë të nevojave për personel dhe për objekte shkollore. Kjo ka bërë që shumica e fondeve (mbi 90 %) në arsim të investohen në paga dhe shpenzime kapitale. Rrjedhimisht, për shkak të fokusimit të fondeve në paga, kanë pësuar rënie investimet në kushtet e punës dhe në mjetet mësimore, gjë që ka dëmtuar cilësinë e mësimin. Në anën tjetër, pas lëvizjes së popullsisë në drejtim të qendrave urbane dhe vendeve perëndimore një numër i konsiderueshëm i objekteve shkollore kanë ngelur të shfrytëzohen nën kapacitetin e tyre të projektuar. Të gjitha këto ndryshime kanë bërë që sistemi arsimor në Kosovë të bëhet tejet joefikas (shpenzimet e shtuara për numrin e zvogëluar të nxënësve) dhe joefektiv (rënia e cilësisë dhe pamundësia e përgatitjes së fëmijëve për jetë).

⁷ Zakonisht, komunat nuk ndajnë mjete për financimin e arsimit nga mjetet vetanake, me përjashtim të investimeve në pajisje ose në ndërtimin e institucioneve parashkollore ose të shkollave. Investimet komunale në arsim zakonisht ndodhin tek komunat më të mëdha (si Prishtina, Prizreni, Peja), të cilat kanë mundësi të ndajnë mjete nga të hyrat e veta për të përmirësuar gjendjen në arsim.

⁸ Pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale në arsimin parauniversitar mbulohen nga granti qeveritar.

Analizë e trendëve demografikë e financiarë në arsimin parauniversitar në Kosovë gjatë dekadës së fundit

Me qëllim të sigurimit të një perspektive më dinamike të trendëve lidhur me shkollat e vogla dhe paralelet e ndara, janë krahasuar të dhënat statistikore të arsimit kosovar gjatë dekadës së fundit. Variablat kryesore të trajtuara janë numri i nxënësve, fondet buxhetore për financimin e shkollave (shërbime e mallra, paga, dhe shpenzime kapitale) nga granti specifik i arsimit në komuna, numri i mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, raporti nxënës – mësimdhënës, numri i shkollave dhe paraleleve të ndara, si dhe numri i paraleleve të nxënësve në shkollat fillore e të mesme të ulëta në Kosovë. Trendët e këtyre variablave janë shprehur në vlera numerike dhe në përqindje (që të dallohen nga vlerat e shënuara gjatë një dekade).

Tabela 1. Trendët demografikë dhe investimet në arsimin parauniversitar në Kosovë gjatë dekadës së fundit.

Viti	Numri i nxënësve	%	Financimi në mil. €	Numri i msdh.	%	Raporti Msdh / nx.	Nr. shko./ pn	%	Nr paral fm	%
2011	322507 t 302253 fm 20254 pf	- - -	€ 109.8 tot € 93.6 pg € 12.8 shm € 3.2 shk	17856 pf,f,mu		18.0	1228 1077 fm		13192	24.0
2013	306994 t 286677 fm 20317 pf	- 3% -	€ 141.1 m € 124.2 pg € 12.8 shm	17663 pf,f,mu		16.6	1174 998 fm 386 pn		12935	22.1
2016	280119 t 258464 fm 21655 pf	- 8% -	€ 161.3 tot / /	17563 pf,f,mu		15.8	1131* 969 fm 358 pn		/	/
2019	256106 t 235161 fm 20945 pf	- 7% -	€ 184.9 tot € 169.7 pg € 11.1 shm	17453 pf,f,mu		14.3	1116 947 fm 332 pn		12665	19
2023	231912 t 212967 fm 18946 pf	- 9% -	€ 194.6 tot € 178.4 pg € 13.6 shm € 2.3 shk	17099 pf,f,mu		13.5	1044 869 fm 265 pn		12,321	17.3
2011 Vs 2023	- 25 %		+ 77 % + 90 % +6.2 % - 34 %	- 4.25		- 25%	- 19.3%		- 6.5%	

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (Statistikat arsimore për vitet 2011, 2013, 2016, 2019, 2023 Ministria e Financave -Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011, 2013, 2016, 2019, 2022.

Legjenda:

Numri i nxënësve – shtylla e dytë jepet për numrin e përgjithshëm të nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (t), numri në shkollën fillore dhe të mesme të ulët (fm) dhe për numrin e fëmijëve në klasën parafillore (pf).

Të dhënat për financat jepen për vlerën e përgjithshme (t), për paga (pg), shërbime e mallra (shm), dhe shpenzime kapitale (shk).

Nga tabela më lart dëshmohet një trend i qëndrueshëm i rënies së numrit të nxënësve në arsimin parauniversitar në Kosovë prej rreth 3 % në shkallë vjetore. Prej vitit 2013 deri në vitin 2023 numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët ka rënë prej 306994 në 231912 nxënës, që i bie 75,082 nxënës më pak, e që shprehur në përqindje i bie 25 % më pak nxënës gjatë një dekade. Rënia e numrit të nxënësve gjatë kësaj dekade është reflektuar edhe në numrin mesatar të nxënësve për një mësimdhënës, prej 16.6 në 13.5 nxënës për mësimdhënës, për arsye se dinamika e pensionimit dhe punësimit të mësimdhënësve nuk e ka përcjellë trendin e rënies së numrit të nxënësve. Domethënë, krahas rënies së numrit të nxënësve (prej rreth 2.5 – 3.0 % në vit), numri i mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët ka mbetur pothuajse i njëjtë duke shënuar rënie prej më pak se 0.25 % në vit, në kohën kur numri i nxënësve ka shënuar ritme deri dhjetë herë më të larta të rënies. Edhe numri i paraleleve gjatë kësaj periudhe shënon vlera të qëndrueshme (me një rënie prej vetëm rreth 0.5 % në vit) krahasuar me rënie deri gjashtë herë më të madhe të numrit të nxënësve. Domethënë, është ruajtur numri i paraleleve për të mbuluar normat e numrit të madh të mësimdhënësve, përkundër rënies pesë deri gjashtë herë më të madhe të numrit të nxënësve gjatë periudhës së njëjtë (2013-2023).

Sa i përket numrit të shkollave vërehet një trend gradual i rënies (prej rreth 10 shkollave ose rreth 1 % në vit) në nivelin e shkollave dhe të paraleleve të ndara të nivelit fillor/ të mesëm të ulët në mes të viteve 2013 dhe 2019. Mirëpo, prej vitit 2019 deri në vitin 2023 rritet trefish shuarja e shkollave, si në numrin e përgjithshëm të shkollave fillore e të mesme të ulëta (prej 947 në 869 ose për 78 njësi më pak), ashtu edhe në numrin e paraleleve të ndara (prej 332 në 265 njësi) të këtij niveli. Siç shihet, shumica e këtyre objekteve të mbyllura shkollore i takojnë kategorisë së paraleleve të ndara (rreth 67 njësi ose gati 20 % më pak nga numri i përgjithshëm i paraleleve të ndara gjatë tri a katër viteve). Të dhënat e MASHTI-t tregojnë se pos paraleleve të ndara gjatë kësaj periudhe kanë pushuar veprimtarinë arsimore edhe 11 shkolla të vogla amë në të gjitha komunat e Kosovës.

Njëkohësisht, financimi në arsim ka shënuar trend jo shumë të favorshëm, sidomos sa i përket sigurimit të një mjedisi mundësues për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor. Kuotat dhe kriteret themelore për financimin e arsimit në nivel komunal, respektivisht për financimin e funksionimit të shkollave nuk kanë ndryshuar që nga koha kur arsimi kosovar administrohej nga UNMIK-u (deri në vitin 2004). Kështu, nëpërmjet të grantit specifik komunal për arsim⁹, shkollat në Kosovë sot e kësaj dite financohen në bazë të kuotave dhe kriterëve në vijim (Ministria e Financave 2022):

- 23 euro për një nxënë me mësim në gjuhën shqipe, respektivisht 25 euro për një nxënë nga komunitetet pakicë për kategorinë e shërbimeve dhe mallrave,
- 1500 euro për shkollë fillore/ të mesme të ulët dhe 3250 euro për shkollë të mesme të lartë dhe shkollë profesionale (edhe këto për kategorinë e shërbimeve dhe mallrave),
- shtatë euro për një nxënë në emër të shpenzimeve kapitale, si dhe
- kuota prej një mësimdhënës për 21.3 mësimdhënës për mësim në gjuhën shqipe, 14.1 nxënë për një mësimdhënës për mësim në gjuhët e komuniteteve pakicë e shkollat në zonat kodrinore/malore, si dhe 17.9 nxënë për një mësimdhënës në shkollat profesionale.

⁹ Mjete financiare të dedikuara për arsim që transferohen nga burimet e buxhetit qendror për të mbuluar pagat e personelit, shërbimet e mallrat dhe investimet kapitale për organizimin e mësimi në nivel komunal.

**Për 15 vjet që nga shpallja e
pavarësisë e deri sot, pagat në arsimin
parauniversitar janë rritur prej rreth**



sa kanë qenë në vitin
2010 në mbi

500 €

në vitin 2023 (Kuvendi i
Kosoves 2023),

ndërkaq kriteret prej

23/25€

për nxënës

**1500/
3250€**

euro për shkollë (për
shërbime e mallra)

dhe kriteri 7 euro për nxënës për shpenzime kapitale nuk janë rritur asnjëherë.

Duhet vërejtur se trendët në arsim në Kosovë, në veçanti dimensionin demografik (rënia e numrit të nxënësve) dhe financiar (rritja e shumës së përgjithshme të financimit), gjatë dy dekadave të fundit kanë ndryshuar në masë të madhe, ndërkohë që kriteret për financimin e funksionimit të shkollave kanë ngelur të njëjta. Siç do të shihet në vijim, të gjitha ndryshimet kanë çuar kah rritja e pjesëmarrjes së pagave në shumën e përgjithshme të financimit të shkollave në dëm të sigurimit të cilësisë, sigurimit të teknologjisë e materialeve mësimore dhe krijimit të një mjedisi mundësues për mësimdhënie e të nxënësve. Trendët e këtilla më së rëndi i kanë goditur cilësinë dhe mbarëvajtjen e mësimin në shkollat e vogla dhe në paralelet e ndara.

Konkretisht, siç është dëshmuar më lart, raporti nxënës/ mësimdhënës është 13.5 nxënës për një mësimdhënës ose rreth 40 % nën nivelin e përcaktuar në dispozitat përkatëse ligjore të MASHTI (MASHT 2013) prej 21.4 për arsimin e përgjithshëm, respektivisht 17.9/14.1 (për arsimin profesional dhe komunitetet). Për 15 vjet që nga shpallja e pavarësisë e deri sot, pagat në arsimin parauniversitar janë rritur prej rreth 200 euro sa kanë qenë në vitin 2010 në mbi 500 euro në vitin 2023 (Kuvendi i Kosoves 2023), ndërkaq kriteret prej 23/25 euro për nxënës, 1500/3250 euro për shkollë (për shërbime e mallra) dhe kriteri 7 euro për nxënës për shpenzime kapitale nuk janë rritur asnjëherë. Pra, pagat e mësimdhënësve janë rritur më shumë se dyfish, ndërsa fondet për shërbime e mallra, mjete materiale, teknologji arsimore dhe shpenzime kapitale kanë pësuar rënie reale (për shkak që bazohen në numrin në rënie të nxënësve dhe të shkollave).

Më konkretisht, pjesëmarrja e pagave në shumën e përgjithshme të grantit specifik për arsim është rritur prej 85.9 % në vitin 2011 (Ministria e Financave 2010) në 91.6 % në vitin 2023 (Ministria e Financave 2022). Njëkohësisht, shërbimet dhe mallrat kanë rënë gati për gjysmë prej 11.65 % në vitin 2011 në 6.9 % në vitin 2023, sikur edhe shpenzimet kapitale të cilat kanë rënë prej 2.9 % në vitin 2011 në 1.1 % (Ministria e Financave 2010) e shumës së përgjithshme të grantit në vitin 2023. Trendi i këtillë ka ndikuar dukshëm në mundësitë e komunave që të sigurojnë kushte për punë, mjete materiale dhe pajisje për zhvillim cilësor të mësimin.

Të gjitha këtyre duhet shtuar edhe faktin se kriteri për 1500 euro për një shkollë të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët nuk aplikohet për paralelet e ndara, por llogaritet vetëm për numrin e shkollave amë.¹⁰ Kjo qasje nuk ka mbështetje në logjikën e funksionimit të shkollave. Në të vërtetë, paralelet e ndara themelohen me vendim të veçantë të komunës përkatëse (domethënë janë entitet ligjor), kanë objekt të veçantë shkollor dhe struktura e shpenzimeve është e njëjtë me strukturën e shpenzimeve të një shkolle amë. Domethënë, edhe paralelet e ndara, sikurse shkollat amë kanë shpenzime komunale (rryma, ujësjellësi, interneti), përdorin mjetet nga pozicioni i shërbimeve e mallrave (materiale shpenzuese, higjienike, mësimore), dhe kanë paga shtesë për personelin e mirëmbajtjes. Në kohën kur kategoritë e sipërpërmendura nuk janë rritur (pothuajse aspak) në dy dekadat e fundit, mungesa e pagesës së funksionimit të paraleleve të ndara vetëm sa e rëndon krijimin e kushteve të duhura për mësim në paralelet e ndara. Një politikë e tillë qartazi dekurajon funksionimin e paraleleve të ndara dhe nxit konsolidimin e shkollave për të inkurajuar efikasitetin e organizimit të mësimi (përmes ekonomisë së shkallës). Mirëpo, përderisa një dekurajim i tillë ka ndikuar fare pak në themelimin e paraleleve të ndara, mungesa e mjeteve financiare për ngrohje dhe shërbime komunale me siguri ndikon në masë të dukshme në cilësinë e mjedisit mësimor dhe kushteve për punë e mësim në paralelet e ndara. Domethënë, duhen menduar forma të tjera për nxitjen e konsolidimit të shkollave dhe për rritjen e efikasitetit të organizimit të mësimi.

Ky trend i ka goditur të gjitha shkollat në Kosovë, mirëpo efektin e tyre e ndjejnë më shumë shkollat e vogla dhe paralelet e ndara, pasi që me numrin e vogël të nxënësve ato kontribuojnë dukshëm më pak në sigurimin e prurjet e fondeve në grantin specifik për arsim të komunave. Gjendja rëndohet edhe më, si shkak i një udhëzimi të Ministrisë së Financave, i cila i ndalon investimet në shkollat me më pak se 100 nxënës!¹¹ Kësisoj, situata e krijuar, i vë shkollat e vogla në një rreth vicioz në të cilin për shkak të numrit të vogël të nxënësve nuk ka investime në infrastrukturë e cilësi e si rrjedhojë mungesa e investimeve e përkeqëson edhe më shumë mungesën e kushteve dhe të cilësisë, kështu që prindërit hezitojnë t'i regjistrojnë fëmijët në këto shkolla, shpesh duke lëvizur me familje në qytete në kërkim të jetës e kushteve më të mira. Rrjedhimisht, shumica e këtyre shkollave kanë hyrë në një cikël të pa perspektivë dhe humbje të shpresës. Kjo ndikon në vullnetin e personelit për mësimdhënie dhe në motivimin e nxënësve që të nxënë. E gjithë kjo mbase ka rezultuar edhe në lënien pas dore të shkollave të vogla dhe paraleleve të ndara nga autoritetet komunale, e dëshmuar nga prindërit, mësuesit dhe drejtorët e intervistuar të shkollave të vizituara në kuadër të hulumtimit për këtë raport. Nga kjo rezulton se shkollat realisht nuk i kontribuojnë mbajtjes së popullatës në zonat e largëta.

Në fund, duhet theksuar se qasja bashkëpunuese (në mes të autoriteteve qendrore dhe atyre vendore) është rruga më e mirë në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe ngritjes së efikasitetit të sistemit. Po ashtu, autoritetet vendore kanë rol të pazëvendësueshëm në përcaktimin e rrjetit të shkollave në komunën e tyre. Kjo theksohet edhe në një studim nga Nusche e të tjerë, që kishin gjetur se: "Veçanërisht në vendet me traditë të zhvilluar të autonomisë vendore, përfshirja e komuniteteve vendore në ristrukturimin e rrjetit të shkollave mund të jetë më efektive se sa drejtimi i procesit nëpërmjet të rregulloreve qendrore, pasi që përfshirja vendore mundëson që të merren parasysh veçoritë e konteksteve vendore. Megjithatë, autoritetet qendrore duhet të sigurojnë që strukturat e rrjetit shkollor të jenë prioritet në agjendën e politikave vendore dhe që ato të udhëhiqen nga cilësia e shërbimeve shkollore dhe nga efikasiteti ekonomik i funksionimit të tyre (Nusche 2009).

¹⁰ Në bazë të bisedës me zyrtarë komunalë të arsimit dhe me zyrtarë të Ministrisë së Financave.

¹¹ Zyrtarët e komunave të vizituara kanë përmendur një udhëzim të tillë, mirëpo gjatë kryerjes së hulumtimit për këtë raport nuk janë ofruar dëshmi me shkrim për një gjë të tillë. Pyetja përkatëse drejtuar në Ministrinë e Financave po ashtu ka mbetur pa përgjigje. Kornizat Afatmesme nuk përmendin udhëzime të këtilla.

Bazuar në rezultatet e testit PISA të nxënësve kosovarë për vitet 2015 dhe 2018 del se madhësia e paraleles (numrit të nxënësve) ka korrelacion të fortë me performancën e nxënësve në lëndën e matematikës, shkencave natyrore dhe shkrim/lexim-it. Kështu, performanca e nxënësve kosovarë shënon ngritje për këto tri fusha kurrikulare sipas tabelës në vijim:

Tabela 2: Suksesi i nxënësve kosovarë në testin PISA dhe madhësia mesatare e paraleleve.

	Deri 15 nx	16-20 nx	21-25 nx	26-30 nx	31-35 nx	36-40 nx	41-45 nx
Shkenca natyrore							
Viti	mesatare	mesatare	mesatare	mesatare	mesatare	mesatare	mesatare
2018	341	344	347	360	383	378	369
2015	356	339	359	366	408	384	‡
Matematikë							
2018	340	343	347	358	387	386	370
2015	329	322	344	352	389	364	‡
Shkrim/lexim							
2018	332	327	329	347	376	374	361
2015	307	305	322	332	380	360	‡

Burimi: Testi PISA 2015 e 2018, Sektori i MASHTI për standarde e vlerësim

Në bazë të kësaj tabele, vërehet një tendencë e fuqishme e rritjes së rezultatit të nxënësve në testin PISA në të tria fushat në përputhje me rritjen e numrit të nxënësve në paralele. Rezultatet më të mira për të tria fushat arrihen në paralelet me 31-35 nxënës, për të shënuar pastaj rënie në paralelet me 36 – 40 nxënës; ndërkaj rezultatet më të ulëta arrihen në paralelet me më pak se 20 nxënës. Është me rëndësi të theksohet se edhe devijimi standard i rezultateve është më i lartë për paralelet më të vogla (rreth 8.0 pikë për paralelet me më pak se 20 nxënës) ose rreth 10 pikë për paralelet më të mëdha, krahasuar me vlerën e devijimit standard prej rreth 2-3 pikë për rezultatet e paraleleve me 31-35 nxënës.¹² Megjithatë këto rezultate tregojnë performancën e nxënësve të moshës 15 vjeçare (moshë e përfshirë në testin PISA), prapë se prapë kjo tregon se numri i nxënësve në paralele/ klasë ka korrelacion të fortë me suksesin në tri fushat kurrikulare të vlerësuara në testin PISA.

¹² Vlerat më të larta të devijimit standard mund të tregojnë për besueshmëri më të ulët të rezultateve për shkak të numrit më të vogël të respondentëve në këtë kategori. Kjo është normale pasi që shumica e nxënësve të moshës 15 vjeçare vijojnë shkollimin në shkolla të mesme. Njëkohësisht, këto të dhëna mund të jenë tregues i mirë për ata nxënës 15 vjeçar që i nënshtrohen testit PISA, por që vijojnë mësimin në shkollat fillore (klasa e 9) nga shkollat e vogla.

Të lidhura ngushtë me rezultatet e mësipërme, janë edhe rezultatet nga testi PISA sipas vendndodhjes së shkollës ku mësojnë nxënësit e testuar. Rezultati i nxënësve në testin PISA shënon rritje stabile me rritjen e madhësisë së vendbanimit nga i cili vijnë nxënësit e testuar.

Tabela 3: Rezultatet e nxënësve nga testi PISA sipas vendndodhjes së shkollës.

	Fshat	Qytet i vogël	Qytet	Qytet i madh
SHKENCAT NATYRORE				
	Pikë	Pikë	Pikë	Pikë
2018	348	350	362	389
2015	356	367	380	395
MATEMATIKË				
2018	343	353	363	392
2015	339	350	363	378
LEXIM				
2018	329	338	352	378
2015	320	333	348	370

Burimi: Sektori i MASHTI për Standarde dhe Vlerësim

Siç shihet nga tabela, dallimi në rezultatet në testin PISA në mes të nxënësve nga fshati dhe nga qyteti i madh dallojnë për 40 – 50 pikë që është e barabartë mesatarisht me dijen e fituar të një nxënësi për një vit të plotë shkollor. Po ashtu vërehet se as qytetet e vogla nuk dalin mirë në rezultatet e testit PISA, pasi që shënojnë dallim të vogël me fshatrat dhe dallim të rëndësishëm me rezultatin e nxënësve nga qytetet e mëdha. Në këtë kontekst do të ishte me rëndësi që edhe testet e standardizuara në Kosovë (matura, testi i arritshmërisë dhe testi i klasës së pestë) po ashtu të mbledhin të dhëna të diferencuara sipas madhësisë së paraleles/klasës dhe vendndodhjes së shkollës.

Rezultatet nga këto dy tabela tregojnë se madhësia e paraleles dhe vendndodhja e shkollës kanë rëndësi të konsiderueshme për performancën (suksesin) e nxënësve në arsim. Performanca e nxënësve, edhe sipas kornizës kombëtare për sigurimin e cilësisë (MASHT 2016) është një ndër treguesit kryesorë të cilësisë dhe të efikasitetit të sistemit të arsimit. Rrjedhimisht, është me rëndësi që Kosova të trajtojë më seriozisht çështjen e rrjetit të shkollave përmes konsolidimit të shkollave, ristikurimit të menaxhimit të shkollave (individuale dhe një grupi të shkollave), si dhe bashkëpunimin në mes të shkollave të vogla me ato më të mëdha.

**Metodologjia
e hulumtimit**

2

Hulumtimi është organizuar në formë të (i) studimit të literaturës dhe në formë të (ii) hulumtimit empirik cilësor i përbërë nga (a) vëzhgimi i shkollave, (b) intervistat me faktorët kryesorë dhe (c) diskutimet në grupe fokusi.

Në kuadër të hulumtimit të literaturës janë analizuar dokumentet ligjore, politikat kryesore, raporte të ndryshme vendore e ndërkombëtare, informata për arsimin në vendet në rajon e në botë, të dhënat statistikore për organizimin e arsimit parauniversitar në vend e jashtë, rezultatet e testeve të standardizuara, si dhe praktikrat e mira ndërkombëtare.

Në kuadër të hulumtimit empirik, janë vizituar 6 komuna dhe 12 shkolla të vogla/ paralele të ndara. Janë takuar/ intervistuar/ konsultuar: një kryetar komune, dhjetë drejtorë komunalë të arsimit, rreth njëzet zyrtarë të DKA-ve, gjashtë drejtorë shkollash amë, rreth tridhjetë e pesë mësime, një numër i konsiderueshëm i nxënësve (mbi 30), si dhe mbi dyzet prindër.

Për realizimin e hulumtimit empirik janë hartuar (i) protokoli i vëzhgimit dhe (ii) pyetësi për intervista me grupet e fokusit. Në protokollin e vëzhgimit janë përfshirë: vëzhgimi dhe fotografimi i mjedisit të jashtëm, rrethojave, terreneve sportive, hapësirave të përbashkëta brenda shkollës, klasat e mësimit, pajisjet dhe mjetet e konkretizimit, mirëmbajtja, ngrohja, ujësjellësi, hapësirat sanitare, e të tjera. Në pyetësin e intervistave të tipit gjysmë të kontrolluar, janë paraparë pyetje lidhur me kushtet e punës e të mësimit, cilësisë në mësim, sfidave dhe rrugëve të mundshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve arsimore në ShV dhe PN.

Janë vëzhguar dhe analizuar mjedisi i brendshëm dhe i jashtëm, kushtet e punës, dokumentacioni pedagogjik, rregullsia në punë, gjendja e objektit dhe funksionimi i shkollave të vogla dhe paraleleve të vogla. Gjatë bisedave me menaxhmentin, mësime, dhe me nxënësit janë diskutuar tema si kushtet e mësimit, metodologjia e punës, qëndrimet e mësimeve lidhur me punën në shkolla të vogla, kënaqshmëria e nxënësve me shërbimet arsimore e të tjera, socializimi e mirëqenia e nxënësve, trendi demografik, si dhe rrugët e ndryshme për mësim dhe nxënie cilësore.

Po ashtu, janë organizuar katër diskutime në grupe fokusi me prindërit e nxënësve nga një shkollë e vogël dhe tri paralele të ndara. Me prindërit është diskutuar rëndësia, roli dhe funksioni i shkollës për komunitetin dhe fëmijët e tyre. Po ashtu, u diskutua cilësia e shërbimeve arsimore, infrastruktura shkollore, si dhe sfidat dhe rrugët për sigurimin e kushteve për mësim cilësor për fëmijët e tyre.

**Politikat kryesore
dhe korniza
ligjore**

3

Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

Në bazë të këtij Ligji (Neni 5, paragrafi 1 Detyrat e Ministrisë) MASHTI mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar dhe për këtë qëllim (nën-paragrafi 1.1.) zhvillon politika, si dhe harton dhe zbaton legjislacionin për zhvillimin e arsimit dhe aftësimin parauniversitar (Kuvendi i Republikës së Kosovës 2011). Përgjegjësia e MASHTI-t për sigurimin e cilësisë është e rëndësishme, pasi që sipas gjetjeve të hulumtimit të funksionimit të shkollave të vogla është pikërisht cilësia ajo që dëmtohet më shumë me funksionimin e shkollave të vogla dhe të paraleleve të ndara.

Ndërkaq, neni 2 i këtij Ligji përcakton qëllimet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar. Sipas kësaj dispozite, detyrat kryesore të arsimit parauniversitar ndër të tjera janë: “(2.1.) *zhvillimi i personalitetit, talentit dhe aftësisë mendore e fizike të nxënësit deri në potencialin e tij të plotë*; (2.2.) *avancimi i krijimit të njohurive themelore shkencore, shkathtësive të komunikimit, vërtetimit dhe shkathtësive analitike, kreativitetit, mëvetësisë dhe aftësive të ndërlidhura të mësimnxënies*; si dhe (2.5.) *përgatitja e nxënësit për jetesë të përgjegjshme*”. Siç do të shihet në vijim në këtë raport, pothuajse të gjitha detyrat kryesore të këtyre dispozitave mbesin të parealizuar në shkollat e vogla dhe në paralelet e ndara të vizituara në kuadër të hulumtimit të realizuar për këtë raport. Kuptohet se i tërë arsimi kosovar çalon në shumicën e këtyre dispozitave, mirëpo problemet në shkollat e vogla dalin të zmadhuara krahasuar me gjendjen e përgjithshme në sistemin arsimor parauniversitar në Kosovë. Po ashtu, më tutje në raport theksohet se një vlerësim i tillë i gjendjes nuk është reflektim i cilësisë së punës dhe i angazhimit të shumicës së mësimeve në shkollat e vogla.

Më tutje, neni 3 i këtij ligji përcakton obligimin e autoriteteve arsimore që të sigurohet përfshirja e të gjithë fëmijëve në arsim, dhe përgjegjësinë për realizimin e shkollimit të fëmijëve, duke theksuar se: (2) “*Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj*”. Kjo dispozitë obligon autoritetet arsimore që të punojnë për mbarëvajtjen e sistemit arsimor duke bashkëpunuar në realizimin e përgjegjësisë të përbashkët. Kjo dispozitë njëkohësisht e përjashton qasjen e centralizuar dhe instruktive në të mirë të bashkërendimit të përpjekjeve në të gjitha etapat për arritjen e qëllimeve.

Neni 13 rregullon themelimin e institucioneve arsimore. Pika 1 e këtij neni përcakton se shkollat fillore (niveli 1 i ISCED-it) dhe të mesme të ulëta (niveli 2 i ISCED-it) themelohen në çdo komunë dhe se shkollat e këtyre niveleve mund të kombinohen. Kjo dispozitë hap mundësinë që komunat të jenë më kreative dhe më fleksibile në themelimin dhe funksionimin/ shkrirjen e shkollave të këtyre niveleve. Për shembull, mësimi në nivelin 1 të ISCED (klasat 0-5) do të mund të zbatohet në mënyrë më të decentralizuar, ndërsa për klasat 6-9 do të mund të bëhet konsolidimi i shkollave dhe bartja e nxënësve në shkollat më të mëdha.

Pika 2. e nenit përcakton se “Komuna mund të themelojë dhe mbajë paralele të ndara të nivelit 1 dhe 2 të ISCED-it në zonat në të cilat nuk ka shkolle amë, sipas kriterëve të vendosura nga Ministria me aktin nënligjor”. Korniza ligjore (shih dispozitat 1 dhe 2 më lart) që u jep autoriteteve lokale – komunave – të drejtën pothuajse ekskluzive për themelimin e institucioneve edukative e arsimore, ka rezultuar në investime pa objektiva të qarta arsimore ashtu që janë hapur shkolla të reja edhe në zona të largëta ku nuk ka pasur arsyeshmëri për një veprim të tillë. Vendimi (AGJ 1977/22) i Gjykatës Kushtetuese (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës 2022), i cili u jep të drejtë të plotë komunave për themelimin dhe shuarjen e shkollave vetëm sa e ka rritur pamundësinë e aplikimit të një qasjeje sistematike dhe të planifikuar për konsolidimin e rrjetit të shkollave në arsimin parauniversitar në Kosovë. Në këtë kuptim, një studim i OECD-së konstaton se “*Shpërputhjet në*

mes të prioriteteve dhe politikave shtetërore për rrjetin shkollor dhe proceseve (rregulloreve) për themelimin e shkollave të reja, [siç është rasti në Kosovë – vërejtje e autorit të këtij raporti] mund të kufizojë shumë mundësitë për planifikimin strategjik të rrjetit të shkollave dhe të dëmtojë rëndë përpjekjet për riorganizimin dhe konsolidimin e shërbimeve arsimore”.

Neni 14 i LAPU rregullon caktimin e nxënësve nëpër institucionet arsimore. Sipas kësaj dispozite komuna është përgjegjëse të caktojë zonat e gravitimit (për nivelt 1 dhe 2 të ISCED) për vijimin e mësimin nga nxënësit e zonave përkatëse. Komuna po ashtu ka mundësi që, në interesin më të mirë të nxënësit dhe në raste të veçanta të bëjë përjashtime nga zona e caktuar për vijimin e mësimin. Në të vërtetë hulumtimi i zhvilluar nëpër shkollat e vogla dhe paralelet e ndara ka treguar për përjashtime të shpeshta në zbatimin e dispozitave të këtij neni. Janë tri gjetje kryesore lidhur me këtë situatë: (i) këto lëshime zakonisht ndodhin në nivel të shkollave, (ii) ka një tendencë të regjistrimit të fëmijëve kah vendbanimet më të mëdha (nga fshatrat në qytete dhe nga qytetet e vogla tek ato më të mëdha), dhe (iii) jo rrallë, nxënësit e zhvendosur i mbajnë në evidencë si shkolla e parë dhe ajo pranuese. Kjo e fundit mbase bëhet për të shtuar numrin e nxënësve në shkollë dhe në komunë në mënyrë nominale dhe mundësohet për shkak të mungesës së kodit personal për secilin nxënës. Arsye të tjera të theksuara nga zyrtarët dhe nga mësimdhënësit e intervistuar janë vendi i punës së prindit (prindi shkon në punë dhe fëmija në shkollë njëkohësisht), mungesa e kushteve adekuatë të mësimin në shkolla të vogla dhe, ndonjëherë, cilësia e mësimdhënësve. Kjo e fundit nuk është verifikuar gjatë hulumtimit në terren pasi që mësimdhënësit e paraleleve të ndara të vizituara kanë treguar cilësi dhe përkushtim të theksuar.

Ndër detyrat e Ministrisë sipas nenit 5 të këtij Ligji përfshihen edhe hartimi i një akti normativ për rregullimin e (5.8.) standardeve të licencimit të institucioneve arsimore dhe aftësuese, përfshirë edhe standardet e cekura në paragrafin 7 (për hapësirën shkollore). Në kontekstin e këtij studimi, kjo dispozitë mund të lexohet edhe si nismë për rishikimin e aktit përkatës normativ për licencimin e institucioneve edukative arsimore përcaktimin edhe të standardit përkatës minimal të pajisjeve, materialeve mësimore dhe mjeteve të konkretizimit për të gjitha institucionet edukative arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë. Domethënë komunat duhet të kenë një akt normativ ku do të përcaktoheshin kërkesat përkatëse minimale për funksionimin e një institucioni edukativo-arsimor. Udhëzuesi i MASHTI për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore (MASHT 2015) parasheh vetëm normat dhe standardet përshkruese, por jo edhe aspektet sasiore dhe cilësore. Për shembull, parasheh madhësinë dhe karakteristikat e kthinave për laboratorë, mirëpo jo edhe se çfarë laboratorësh duhet të ketë ndërtesa shkollore dhe me cilat pajisje brenda tyre.

Në anën tjetër Udhëzimi Administrativ MASHT 11/2012 për kriteret për licencimin e institucioneve arsimore private për nivelin fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë dhe institucioneve aftësuese profesionale (MASHT 2012) rregullon kërkesat administrative për licencim pa caktuar asnjë standard të kërkuar për funksionim cilësor të institucionit arsimor. Domethënë në sistemin arsimor të Kosovës nuk parashihi standardet e sasisë dhe cilësisë së hapësirave mësimore (laboratorë, kabinete, punëtori), të pajisjeve, të mjeteve materiale, të mjeteve të konkretizimit përmes së cilave do të vlerësohej cilësia e funksionimit dhe e shërbimeve arsimore për institucionet parauniversitare të përgjithshme. Për ilustrim, autoritetet arsimore komunale dhe institucionet edukative – arsimore (përfshirë ato private) nuk kanë një dokument referues se sa dhe cilat kabinete duhet t'i ketë shkolla si standard minimal i veprimtarisë së saj. Po ashtu, nuk ka asnjë dokument që përcakton se cilat shërbime arsimore e profesionale duhet të ofrojë shkolla (aktivitete në klube, këshillime në karrierë, aktivitete jashtëmësimore, aktivitete të socializimit, përkrahje psikologjike, sociologjike, ...) pos mësimdhënies. Personeli i intervistuar i DKA-ve dhe personeli i shkollave të vogla dhe të mëdha nuk kishin ndonjë orientim se cilët laboratorë/ kabinete/ pajisje duhet të kishin shkollat.

Korniza
përcakton

5

fusha të
vlerësimit

25

kritere

dhe më se

110

indikatorë për
vlerësimin e
performancës së
shkollës.

Ky është dokumenti kryesor që orienton politikat për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Mirëpo, pas rreth shtatë vitesh të jetësimit, duket se Korniza ka nevojë për një rishikim, në mënyrë që të mund të orientojë më mirë politikat dhe praktikatat e autoriteteve dhe institucioneve arsimore në Kosovë.

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës të institucioneve arsimore¹³

Ky dokument (MASHT 2016) i hartuar dhe publikuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës shërben për orientimin e politikave kryesore për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë. Me *Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës*, MASHT-i përcakton pritshmërinë themelore nga çdo shkollë që vepron në Republikën e Kosovës, përmes **kritereve të cilësisë** dhe **treguesve të performancës** së shkollës. **Këto standarde** do të shërbejnë si referencë për vlerësimin e performancës së shkollës, planifikimin zhvillimor të saj dhe avancimin e vazhdueshëm të shërbimeve shkollë (nga fjala e Ministrit në hyrje të dokumentit). Korniza përcakton pesë fusha të vlerësimit, 25 kritere dhe më se 110 indikatorë për vlerësimin e performancës së shkollës. Ky është dokumenti kryesor që orienton politikat për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë. Mirëpo, pas rreth shtatë vitesh të jetësimit, duket se Korniza ka nevojë për një rishikim, në mënyrë që të mund të orientojë më mirë politikat dhe praktikatat e autoriteteve dhe institucioneve arsimore në Kosovë. Praktika e zbatimit të saj ka treguar se është tejet e sqaruar dhe e vështirë për implementim nga resurset ekzistuese të shkollave dhe të inspektoratit arsimor në Kosovë. Mirëpo, në këtë rast do të trajtohet vetëm se sa është e qartë korniza në parashtrimin e kushteve minimale infrastrukture të nevojshme për mësim e punë në shkollat e Kosovës.

Për ilustrim do të analizohet shkurt gjuha e kriterit (2.3.) dhe e disa indikatorëve përkatës për mjedisin dhe kulturën e punës në shkollë. Në këtë kriter theksohet se “Mjedisi dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të të nxënies të integruar dhe jetësimit të kurrikulës”. Ky kriter domethënë përcakton pritshmërinë dhe kushtet konkrete minimale në infrastrukturën mësimore në mënyrë që të mundësohet mësimi i integruar dhe realizimi i kurrikulës. Rrjedhimisht, nga indikatorët e këtij kriteri autoritetet dhe institucionet arsimore duhet të kuptojnë kërkesat minimale përkitazi me hapësirat mësimore, laboratorët, kabinetet, mjetet e konk-

¹³ [Korniza-per-sigurim-te-cilesise-se-performances-se-shkolles-ne-Kosove-2016.pdf \(rks-gov.net\)](#)

retizimit, materialet mësimore për realizimin e kurrikulës dhe të mësimi të integruar. Megjithëkëtë, mënyra e formulimit të indikatorëve kryesorë në këtë fushë nuk ofron një pasqyrë të qartë të kërkesave dhe obligimeve minimale të autoriteteve dhe institucioneve arsimore. Për ilustrim, në indikatorin, 2.3.1 thuhet se *“Burimet (njerëzore dhe financiare) dhe pajisjet e mjetet mësimore janë të mjaftueshme për të mundur realizimin e procesit mësimor sipas kërkesave të përcaktuara me kurrikulat bërthamë”*. Nga një formulim i tillë MASHTI, komunat dhe shkollat nuk marrin obligime të qarta në kuptimin e infrastrukturës dhe kushteve për punë dhe mësim. Ngjashëm del po të shikohet indikatorin 2.3.4.: *“Mësimdhënia dhe nxënia pasurohen me shfrytëzimin adekuat të TIK-ut, mjedisit përreth dhe burimeve të tjera jashtë shkollës”*. Këtu nuk është e qartë se cilat pajisje, në çfarë sasi, dhe në çfarë mënyrë duhet të përdoren.

Më tutje, në indikatorin 2.3.5, thuhet se: *“Klasat, laboratorët, hapësirat përcjellëse (të brendshme dhe të jashtme) dhe pajisjet janë në funksion të plotë të realizimit të mësimi të integruar dhe aktiviteteve të tjera me karakter ndër-kurrikular”*.

Në rrethana të tilla, si do ta dijë vlerësuesi i brendshëm, ai i jashtëm, ose drejtori i shkollës nëse janë plotësuar (në njërin nga katër shkallët) kushtet e performancës për këtë kriter? Si do të mund t'i planifikoheshin investimet në arsim autoritetet komunale? Si do të siguroheshin kushte sa më të barabarta të mësimi në mes të shkollave dhe komunave?

Domethënë, kriteret dhe indikatorët duhet të bëhen më të matshëm, më konkretë dhe të normohen si standarde (sa kompjuterë për numër të nxënësve) e jo vetëm si fusha ose përmbytje (pajisje të mjaftueshme për realizimin e kurrikulës). Rrjedhimisht, duhet të vendoset sa kompjuterë, sa laboratorë, cilët laboratorë, çfarë laboratorë, (nuk mjafton që laboratorët të jenë në funksion të kurrikulës, duhet treguar se SI e ndihmojnë realizimin e kurrikulës. Pastaj, si realizohet mësimi i integruar në shkolla përmes laboratorëve? Çfarë laboratorë e realizojnë më mirë mësimin e integruar?

Rrjedhimisht, politikat dhe aktet përkatëse nënligjore duhen rishikuar me qëllim që të përcaktojnë kushte konkrete minimale për ofrimin e shërbimeve të standardizuara arsimore për të gjithë nxënësit në Kosovë. Në asnjë rregullore nuk thuhet saktë se SA dhe CILAT klasa, laboratorë dhe hapësira përcjellëse duhet të sigurohen. Për shembull, secila shkollë fillore dhe e mesme e ulët, si dhe gjimnazet, duhet të sigurojnë mësim të rregullt në laboratorë e kabinete në fushën kurrikulare të shkencave natyrore, në fushën e arteve, në fushën e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (TIK), pastaj hapësirat e mbyllura dhe të hapura për lëndën e sporteve dhe kulturës fizike e të tjera. Po ashtu, duhet përcaktuar se sa laboratorë të një lloji mjaftojnë për madhësinë përkatëse të shkollës – shkollat e mëdha kërkojnë më shumë hapësira të tilla.

Formulimi i tillë lejon standardizimin e kushteve të punës dhe të aktiviteteve mësimore në shkollat kosovare. Shumica e shkollave të vogla dhe e paraleleve të ndara, të vizituara (gjatë hulumtimit) nuk plotësonin kushtet themelore për zhvillim cilësor të mësimi dhe për realizim të kurrikulave. Drejtorët e intervistuar të drejtorive komunale dhe të shkollave nuk e shihnin të arsyeshme që të gjithë fëmijët të kishin kushte të njëjta të mësimi, pa marrë parasysh madhësinë e shkollës apo numrin e nxënësve. Kjo për arsye se asnjë dispozitë ligjore nuk i obligon ata konkretisht për krijimin e kushteve optimale për mësim dhe punë. Përkundrazi, sipas insistimit të zyrtarëve arsimorë të komunave të vizituara gjatë hulumtimit për këtë raport, ka udhëzime nga autoritetet qendrore që nuk duhet investuar në shkolla të vogla.

Njëkohësisht, udhëzimi administrativ UA 17/2016 për licencimin e Institucioneve private arsimore dhe aftësuese të arsimit profesional¹⁴ (MASHT 2016) në nenet 3-4 parasheh vetëm procedurat dhe kriteret (domethënë përmbajtjen e vlerësimit) por jo edhe standardet minimale për licencim. Për ilustrim, në pikën 1.4 përcaktohet se vlerësohen kabinetet, laboratorët dhe pajisjet mësimore, por nuk përcakton se cili është minimumi i përmbajtjes dhe i cilësisë së atyre pajisjeve. Për shembull, sa kompjuterë, projektorë, tabela të mençura, e të tjera duhet të ketë një institucion që të plotësojë kriterin e pajisjeve teknologjike. Rrjedhimisht, ky Udhëzim mund të ketë nevojë për një rishikim me qëllim standardizimi dhe aplikimi edhe përtej institucioneve private edukative dhe arsimore.

Lidhur me kushtet për licencimin e institucioneve arsimore dhe sigurimin e efikasitetit të funksionimit të tyre, një studim i OECD-së (OECD 2018, 101) kërkon që procedurat e licencimit duhet të harmonizohen me përparësitë e politikave arsimore. Përndryshe mund të bjerë efikasiteti i sistemit dhe mundësia për planifikimin e zhvillimit të tij. Ose, thënë ndryshe “vendimi për financimin e institucioneve arsimore duhet të jetë transparent dhe të bazohet në një vlerësim lidhur me nevojat dhe cilësinë. Vetëm shërbimet dhe institucionet e një cilësie të dëshmuar duhet të lejohen të veprojnë, si dhe ato që u përgjigjen nevojave të qarta për shërbime arsimore. Kjo ilustron me kërkesën, që një shkollë nuk duhet të financohet nga fondet publike, përveç nëse dëshmohet se ka siguruar një numër të paraleleve me numër të caktuar të nxënësve. Sot, në Kosovë vazhdojnë të funksionojnë në numër i konsiderueshëm i shkollave të vogla dhe i paraleleve të ndara me numër më të vogël se kriteret e lejuara në dispozitat përkatëse të MASHTI-t, por edhe dukshëm nën nivelin e dëshiruar dhe të lejueshëm të cilësisë së shërbimeve edukative dhe arsimore (do të analizohen në vijim të këtij studimi).

Udhëzimi MASHT Nr. 4/2017 për vlerësimin e performancës së IAAPU

Është një dokument që rregullon procedurat e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës. Neni 6 i këtij Udhëzimi parasheh katër shkallë të cilësisë së performancës duke iu referuar Kornizës për sigurimin e cilësisë të institucioneve arsimore. Ky Udhëzim është në përputhje të plotë me kriteret dhe indikatorët e vendosur në Kornizën për Vlerësim të Performancës (të analizuar më lart). As këtu, nuk përkufizohen standardet minimale të pajisjeve teknologjike, mjeteve materialeve, llojeve dhe të cilësisë së laboratorëve e punëtorëve; domethënë nuk përcaktohen kushtet themelore për funksionimin e një institucioni edukativ e arsimor.

Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës¹⁵ 03/L-068

Dispozitat e këtij ligji (neni 4.1.) japin kompetenca të plota dhe ekzekutive komunale lidhur me arsimin në nivel lokal: “Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për atë sa ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respektojnë standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e

¹⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15135>

¹⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543>

rrogave dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe administratorëve”. Të drejtat ekskluzive të komunave në arsim konfirmohen më tutje në Ligjin për vetëqeverisjen lokale neni 17, i cili rezervon për komunat të drejta të plota dhe ekskluzive në “ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit” (Kuvendi i Republikës së Kosovës 2008).

Lidhur me rrjetin e shkollave dhe themelimin/ shuarjen e institucioneve edukative – arsimore, si formulim i i kësaj dhe dispozitave në vijim i përcakton të drejtat e plota dhe ekzekutive të komunave vetëm në nivel të përgjithshëm. Kështu, në kompetencat konkrete (neni 5) përfshihen: ndërtimi i shkollave, punësimi i personelit, emërimi i drejtorëve të shkollave, mbikëqyrja e shkollave, aftësimi i mësimdhënësve, e të tjera, mirëpo nuk ka asnjë dispozitë lidhur me rolin konkret të komunave për rrjetin e shkollave dhe themelimin/ shuarjen e institucioneve edukative e arsimore. Për këtë arsye, dispozitat e Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe aktet përkatëse nënligjore të MASHTI-t, mbeten dispozita meritore për interpretimin dhe zbatimin e këtyre dispozitave të përgjithshme të këtyre dy ligjeve përkitazi me rrjetin e shkollave dhe themelimin/ shuarjen e IAAP-ve.

Fryma e tillë e rregullimit të themelimit dhe shuarjes së IAAP-ve në Kosovë është kundër praktikave pozitive ndërkombëtare në këtë fushë. Në vendet e OECD-së përgjegjësia për themelimin/ shuarjen e institucioneve arsimore përcaktohet nga burimi i fondeve për funksionimin e arsimit. Kështu, në pjesën më të madhe të vendeve të OECD-së (12 nga 25 vende të analizuara) fondet për arsimin parauniversitar sigurohen nga autoritetet qendrore dhe, njëkohësisht, edhe vendimarrja për funksionimin e shkollave është kryesisht e centralizuar. Ndërkaq, në vendet ku arsimi financohet nga provincat/ rajonet (si Austria, Kanadaja, Gjermania, Australia, SHBA, e të tjera), respektivisht nga komunat (siç ndodh në vendet skandinave) atëherë edhe vendimarrja përqendrohet në këto nivele të pushtetit (Atkinson 2005). Në këtë kuptim, Kosova përbën një përjashtim relativisht të palogjikshëm për arsye se të gjitha fondet për arsimin parauniversitar sigurohen nga buxheti qendror, ndërkaq e tërë vendimarrja (përjashtojë sigurimin e cilësisë) është e fokusuar, *madje në mënyrë ekskluzive*, në nivelin lokal. Gjendja e tillë mund të shpjegohet me ndikimin e fuqishëm të ekspertëve të shumtë ndërkombëtarë në organizimin e arsimit në Kosovë në periudhën e pasluftës si dhe kompromiset në kuadër të procesit të negocimit të pavarësisë së Kosovës si koncesione dhe garanci për pakicat kombëtare, e sidomos për komunitetin serb të Kosovës.

Udhëzimi Administrativ (MASHTI UA Nr. 10/2023) për kriteret dhe procedurat për themelimin dhe pushimin e veprimtarisë së shkollës

Themelimi dhe pushimi i veprimtarisë së institucioneve edukative-arsimore të nivelit parauniversitar rregullohet me Udhëzimin Administrativ të MASHTI nr. 10/2023, i cili përcakton kriteret minimale për funksionimin e një institucioni edukativ – arsimor dhe procedurat përkatëse për themelimin dhe pushimin e veprimtarisë së tij. Në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ (MASHTI 2023), komuna, me pëlqim të MASHTI-t themelon të gjitha institucionet e niveleve ISCED 0-3. Pasi që në fokus të këtij dokumenti është çështja e shkollave të vogla dhe e paraleleve të ndara, këtu nuk do të përqendrohemi në institucionet e nivelit ISCED 3 ku ky fenomen nuk është aq i shprehur. Në vend të kësaj, do të përqendrohemi në gjendjen e institucioneve arsimore të niveleve ISCED 1 dhe 2.

Sipas UA 10/2023 janë disa kritere kryesore për themelimin e një shkolle fillore (ISCED 1):

- të paktën nga një paralele për secilën klasë 1-5 dhe një paralele për klasën para-fillore;
- të paktën 60 nxënës;
- të paktën 30 nxënës për shkollat në gjuhët e komuniteteve pakicë respektivisht shkollat në zonat malore ose kufitare, ku
 - zonë malore quhet zona rurale me lartësi mbidetare 700 m e më shumë;
 - zonë kufitare quhet lokacioni me largësi më të vogël se 5 km nga vija kufitare.

Njëkohësisht, për themelimin e një shkolle fillore dhe të mesme të ulët (ISCED 1&2) duhet të plotësohen këto kritere:

- të paktën nga një paralele për secilën klasë 1-9 dhe një paralele për klasën para-fillore;
- të paktën 100 nxënës;
- të paktën 50 nxënës për shkollat në gjuhët e komuniteteve pakicë respektivisht shkollat në zonat malore ose kufitare.

Ndërkaq, paralelja e ndarë e një shkolle mund të themelohet nëse plotësohen këto kushte:

- Largësia nga institucioni amë nuk është më e vogël se 4 km.
- Paralelja e ndarë ka të paktën 20 nxënës, përkatësisht të paktën 10 nxënës për shkollat në gjuhët e komuniteteve pakicë respektivisht paralelet në zonat malore ose kufitare
- Paralelja e ndarë e nivelit ISCED 1 i ka të paktën dy paralele për klasat e nivelit 1-5, ndërsa ajo e nivelit ISCED 1&2 edhe dy paralele për klasat 6-9.
- Përgjatësisht, paralelja e ndarë mund të themelohet edhe pa plotësimin e kritereve të lartshënuara nëse transporti i fëmijëve nga zona e mbulimit e paraleles së ndarë deri te shkolla më e afërt konsiderohet i rrezikshëm ose zgjat më shumë se 45 minuta në një drejtim.

Gjatë hulumtimit të zhvilluar në gjashtë komuna të Kosovës (ku mësimi zhvillohet kryesisht në gjuhën shqipe) është konstatuar se komunat janë të informuara mirë lidhur me dispozitat përkatëse të këtij UA. Vështirësitë për konsolidimin e rrjetit të shkollave janë më komplekse dhe do të paraqiten në seksionin për analizën e gjendjes në vijim.

Politika e MASHTI për shkollat e vogla dhe paralelet e ndara

**Prezantim
dhe diskutim i
rezultateve të
hulumtimit**

4

Rezultatet e intervistave:

Drejtoritë komunale të arsimit – drejtorët dhe zyrtarët

Në nivelin e autoriteteve komunale arsimore ekziston ndërgjegjësim i plotë lidhur me trendin negativ në funksionimin e shkollave të vogla dhe paraleleve të ndara. Megjithatë, për arsye të ndryshme si: investimet e gabuara në infrastrukturën shkollore, punësimet e tepruara në arsim, mungesa e qasjes sistematike dhe të planifikuar, trajtimi i pabarabartë i shkollave nga zona të ndryshme, mungesa e fondeve, rezistenca nga komuniteti e të tjera, problemi me shkollat e vogla vetëm sa ka vazhduar të përkeqësohet në shumicën e komunave të Kosovës.

Në bisedat me ta, drejtorët dhe zyrtarët komunalë të arsimit deklarohen të interesuar të zbatojnë dispozitat e MASHTI-t për themelimin/ shuarjen e institucioneve arsimore. Kjo nënkupton shuarjen e shkollave ose të paraleleve të ndara me më pak se 10, përkatësisht 20 nxënës. Mirëpo, gjetjet e hulumtimit tregojnë se problemet (sidomos me cilësinë e mësim-it) janë më të thella dhe shkojnë përtej shkollave me 20 nxënës. Të pyetur për ekzistimin e planeve vetanake zhvillimore dhe rregulloreve që do të rregullonin funksionimin e shkollave, furnizimin me pajisje, ose transportin e nxënësve, shumica e autoriteteve deklarojnë mungesë të dokumenteve të këtilla. Përgjithësisht, në ndonjë drejtori deklarohen se kanë plane të tilla, mirëpo deri në hartimin e këtij raporti nuk ka ndonjë dokument konkret të dorëzuar si dëshmi për një gjë të tillë. Rrjedhimisht ka mungesë të një qasjeje sistematike në plan afatmesëm për rregullimin e rrjetit të shkollave në komuna. Në vend të kësaj dominojnë qasjet momentale qoftë si angazhim i kryetarit të komunës ose si reagim ndaj shuarjes graduale të institucioneve të vogla arsimore.

Në bazë të një raporti të Shewbridge për shkollat e Çekisë të hartuar për nevoja të OECD-së, janë tri elemente kryesore që kërkohen nga autoritetet e përgjegjshme vendore për organizim të suksesshëm të rrjetit të shkollave: kapacitetet e duhura (ekspertiza dhe personeli i mjaftueshëm), udhëheqja e qartë dhe përqendrimi në cilësinë arsimore (Shewbridge 2016, 62). Në komunat ku është arritur sukses relativ në konsolidimin e rrjetit të shkollave kemi parë kryesisht elementin e vendosmërisë së udhëheqjes e më pak kapacitetet e duhura dhe përqendrimin në cilësi. Fitohet përshtypja se orvatjet për konsolidim të rrjeteve shkollore në Kosovë ndodhin kur udhëheqjet komunale alarmohen nga mos efikasiteti i skajshëm i sistemit arsimor në komunën përkatëse. Për shembull, në një komunë proporcioni nxënës/mësimdhënës kishte arritur deri në 8 me 1 dhe njëkohësisht ishte shtuar dukshëm numri i shkollave të vogla. Ngjashëm ka ndodhur në disa komuna të tjera që kanë bërë përpjekje për konsolidimin e rrjetit të shkollave. Megjithatë, pothuajse në asnjë rast, konsolidimi i rrjetit apo fuzionimi nuk vërehet të ketë ndodhur si rezultat i përqendrimit në cilësinë e shërbimeve arsimore. Përqendrimi në cilësi nuk duket të jetë preokupimi primar as i prindërve, së paku nga intervistat e organizuara në kuadër të këtij hulumtimi (për më shumë lidhur me qëndrimin e prindërve, shih në pjesën për rezultatet e bisedave me prindër).

Një element tjetër i rëndësishëm për reformim të suksesshëm të rrjetit të shkollave është edhe pjesëmarrja e komunitetit në secilën fazë. Në bazë të një raporti të OECD-së për resurset shkollore (OECD 2018, 70) *“Një element i rëndësishëm i reformës së regjistrimeve dhe rrjetit shkollor të komunitetit flaman në Belgjikë, ishte shkalla e fleksibilitetit në nivelin lokal, bazuar në rolin vendimtar të konsultimeve, që e ka reduktuar dukshëm rezistencën ndaj zbatimit të reformave”*. Në Kosovë, në disa raste vërehet se vendosmëria e udhëheqjes në realizimin e reformave nuk shoqërohet edhe me përfshirje aktive të komunitetit në konsultime të gjera e të durueshme për reforma. Qasjet e këtilla kanë prodhuar pasoja të rënda për mbarëvajtjen e mësimi dhe për shkollimin e fëmijëve. Në këtë kontekst duhet përkujtuar se

konsultimet dhe përfshirja e komunitetit është edhe obligim ligjor në përputhje me nenin 3.2. të Ligjit për arsimin parauniversitar, i cili i bën prindërit një ndër faktorët kryesorë përgjegjës për organizimin e arsimit në Kosovë.

Në dy komuna është trajtuar më seriozisht çështja e shkollave të vogla dhe e paraleleve të ndara, si rezultat i përcaktimit të kryetarit të komunës ose i administratës komunale. Në këto dy komuna është bërë konsolidimi relativ i rrjetit të shkollave me veprim energjik të administratës komunale. Megjithatë, edhe këtu pos vendosmërisë së udhëheqjes, mungon qasja sistematike dhe planifikimi afatmesëm (3-5 vjet) për adresimin e çështjeve. Megjithatë, trajtimi me vendosmëri i çështjes ka rezultuar me rezultate relative dhe ka lehtësuar funksionimin e shkollave. Po ashtu, sipas personelit të këtyre drejtorive komunale, reagimi i komunitetit dhe i nxënësve ka qenë pozitiv pas përfundimit të procesit të konsolidimit¹⁶. Po sipas tyre, vendimtar për suksesin e fuzionimit kanë qenë: vendosmëria, sigurimi i transportit cilësor, sigurimi i vendit të punës së mësimdhënësve dhe komunikimi me komunitetin. Në segmentin e komunikimit me komunitetin theksohet rëndësia dhe roli i drejtorit të shkollës, qartësia e zgjidhjeve të ofruara dhe siguria e nxënësve.

Komunat e tjera tregojnë për vështirësitë dhe rezistencën, shpesh irracionale të komunitetit apo të personelit. Në dy apo tri nga komunat e vizituara, pas disa komunikimeve të pasuksesshme me komunitetin, zyrtarët komunalë kërkojnë përkrahje nga MASHTI për konsolidimin dhe rritjen e efikasitetit të rrjetit të shkollave. Kjo përkrahje, mendojnë se mund të vijë nga politikat më të qarta në njërin anë, por edhe me përkrahje financiare për furnizimin e shkollave dhe sigurimin e transportit, në anën tjetër.

Trendi i lëvizjes së popullatës (kah zonat urbane dhe vendet perëndimore), rënies së numrit të nxënësve (sidomos në zonat rurale) dhe paraqitja e tepricës së mësimdhënësve i ka sjellë shkollat dhe autoritetet komunale para dilemave të rënda për zhvillimet e mëtejme dhe për organizimin e arsimit në komunat e tyre. Nga bisedat me autoritetet komunale, është krijuar momenti për veprim, mirëpo kërkohej përkrahje nga jashtë, në radhë të parë nga MASHTI, në formë të fondeve dhe rregulloreve të qarta. Rregulloret e MASHTI-t përdoren nga autoritetet komunale arsimore si argument për nevojën e konsolidimit të rrjetit të shkollave ose të fuzionimit të shkollave siç parapëlqehet të quhet në nivel komunal.

Lë përshtypje fakti se drejtorët dhe zyrtarët e intervistuar komunalë nuk i shohin problemet e mungesës së cilësisë së shërbimeve arsimore në shkollat e vogla, por më shumë e shohin çështjen nga ana administrative e funksionale. Hulumtimi i kryer për këtë raport ka treguar se problemi kryesor i zhvillimit të mësimit në këto shkolla është dëmi që u shkaktohet fëmijëve në zhvillimin e tyre arsimor dhe në mirëqenien e tyre psikofizike për shkak të mungesës së mjeteve për mësim dhe mungesës së kushteve për socializim të mirëfilltë. Ky aspekt kërkon veprime për informim dhe ngritje të vetëdijes, jo vetëm ndër autoritetet komunale, por edhe të vetëdijesimit të prindërve. Në kontekst të nivelit komunal të arsimit, lë përshtypje po ashtu mungesa e plotë e organizatave joqeveritare aktive në fushën e edukimit e të arsimit. Në asnjë komunë gjatë bisedave me komunitetin nuk dolën nisma dhe aktivitete joqeveritare dhe komunale. Fitohej përshtypja se arsimi është përgjegjësi vetëm e autoriteteve shtetërore dhe aspak përgjegjësi e komunitetit.

16 Në komunat e vizituara përdoret termi i fuzionimit për rastet kur bëhet shuarja e ndonjë paraleleje të ndarë ose shkolle të vogël.


Drejtorët e shkollave

Siç dihet drejtorët e shkollave janë hallka kryesore në relacionin autoritete arsimore – komunitet. Rrjedhimisht, çfarëdo veprimi për sigurimin e shërbimeve cilësore arsimore në shkollat e vogla qoftë përmes fuzionimit ose krijimit të kushteve në shkollat ekzistuese, duhet të fokusohet rreth drejtorëve të shkollave. Aktualisht, nuk vërehet një lidhje e qëndrueshme në funksionim në mes të shkollave amë dhe paraleleve të ndara, sidomos në rastet në zonat me lëvizje të theksuara demografike dhe që shënojnë rënie të vazhdueshme të numrit të nxënësve. Kjo vihet në dukje në rastin e raportit të DKA-ve me shkollat amë me numër më të vogël të nxënësve, fitohet përshtypja se paralelet e ndara nuk e gëzojnë vëmendjen e plotë të menaxhmentit të shkollës.

Mësimdhënësit në mes të kauzës socio-kulturore dhe asaj arsimore

Të gjithë mësimdhënësit (mësuesit) në shkollat e vizituara janë të brengosur lidhur me zhvillimet e mëtejme rreth shkollave ku punojnë, por njëkohësisht ruajnë edhe përkushtimin dhe dashurinë për nxënësit dhe punën e vet. Përderisa, faktorët e tjerë i shohin shkollat e vogla si institucione, si probleme për financim e menaxhim (autoritetet komunale, qendrore, menaxhmenti i shkollave), ose si monumente, infrastrukturë e munguar, apo edhe si kauzë për të cilën duhet luftuar me çdo çmim (prindërit dhe komuniteti), mësimdhënësit e shohin çështjen nga aspekti i kushteve të punës dhe nga (pa)mundësia për të siguruar shërbime cilësore edukative e arsimore për nxënësit e vet. Domethënë, vetëdija dhe angazhimi për sigurimin e cilësisë është më e theksuar te mësimdhënësit se sa te faktorët e tjerë (autoritetet dhe komuniteti). Përrjashtim nganjëherë bëjnë mësimdhënësit më të moshuar, të cilët janë edhe pjesë e komunitetit dhe e menaxhimit të shkollave të vogla. Në këto raste mbizotëron elementi socio-kulturore mbi atë arsimor. Këta mësimdhënësit e shohin veten si aktivist komunal dhe shkollën si kauzë të mbijetesës së komunitetit në një zonë të caktuar, zakonisht kodrinore malore.

Në shumicën e shkollave të vogla vëreheshin përpjekjet e mësimdhënëseve që të kompensohej mungesa e laboratorëve, e pajisjeve dhe e materialeve mësimore përmes riciklimit të materialeve nga jeta e përditshme dhe duke përdorur pajisjet personale teknologjike.



Një shembull i mirë për ilustrim ishte në paralelen e ndarë në Surdull të Podujevës. Mësuesja këtu kishte rregulluar një tavolinë të mjeteve mësimore (këndi i resurseve) që përbëhej nga shishe të ricikluara të mbushura me ujë në ngjyra të ndryshme, pipëza plastike, shkopinj të punuar vetë, plastelinë, shkumësa e lapsa me ngjyra të ndryshme, letër të madhësive, trashësisë dhe ngjyrave të ndryshme. Rezultatet e përdorimit të këtyre materialeve shiheshin nëpër muret e klasës të dekoruara me shkronja shumëngjyrëshe të letrës. Shumica e këtyre materialeve mësimore ishin punuar asisoj që të mund të përdoreshin më gjatë dhe për përmbajtje të ndryshme mësimore.

Kjo qasje, ku më shumë e ku më pak, vërehet në të gjitha shkollat e vizituara dhe kjo mund të lidhet me entuziazmin e mësimdhënëseve të rinj – të cilët zakonisht dërgohen të punojnë në shkollat e vogla e në paralelet e ndara.

Një shembull i mirë për ilustrim ishte në paralelen e ndarë në Surdull të Podujevës. Mësuesja këtu kishte rregulluar një tavolinë të mjeteve mësimore (këndi i resurseve) që përbëhej nga shishe të ricikluara të mbushura me ujë në ngjyra të ndryshme, pipëza plastike, shkopinj të punuar vetë, plastelinë, shkumësa e lapsa me ngjyra të ndryshme, letër të madhësive, trashësisë dhe ngjyrave të ndryshme. Rezultatet e përdorimit të këtyre materialeve shiheshin nëpër muret e klasës të dekoruara me shkronja shumëngjyrëshe të letrës. Shumica e këtyre materialeve mësimore ishin punuar asisoj që të mund të përdoreshin më gjatë dhe për përmbajtje të ndryshme mësimore.

Kjo qasje, ku më shumë e ku më pak, vërehet në të gjitha shkollat e vizituara dhe kjo mund të lidhet me entuziazmin e mësimeve të rinj – të cilët zakonisht dërgohen të punojnë në shkollat e vogla e në paralelet e ndara.

Punëtorët e mirëmbajtjes:

Punëtorët e mirëmbajtjes janë personeli më i pranishëm në të gjitha shkollat e vogla të vizituara gjatë hulumtimit në terren. Shpesh, pikërisht te punëtorët e mirëmbajtjes vërehet ndjenja e pronësisë dhe e identifikimit me shkollën. Përderisa te faktorët e tjerë (drejtoria komunale, menaxhmenti i shkollës amë, e mbase edhe te mësimeve) vërehet një farë distance emocionale e deri në lënie pas dore e shkollës së vogël apo e paraleles së ndarë, te punëtorët e mirëmbajtjes vërehet pak më shumë përkushtim, lidhje me shkollën, me mirëqenien e nxënësve e të mësimeve e të tjera. Janë këta punëtorë që (zakonisht të vetmit) hasen në objekt edhe para dhe pas përfundimit të mësimit; këta janë në gjendje të sigurojnë, shpesh më mirë se të gjithë të tjerët, të gjitha informatat për shkollën, mësimin, gjendjen dhe problemet e shkollës; këta përballen drejtpërdrejt me të gjitha vështirësitë objektive të funksionimit të shkollës dhe me përdorimin e infrastrukturës.

Duhet theksuar se punëtorët e mirëmbajtjes në shkolla të vogla punojnë në kushte më të rënduara se kolegët e tyre në shkolla të tjera pikërisht për shkak të elementeve të lënies pas dore të këtyre objekteve nga autoritetet dhe menaxhmenti i shkollës. Në objektet e shkollave të vogla vërehet përdorimi i shtuar i ujit për pastrim dhe improvizime të shpeshta në rregullimin e rrethojës së shkollës, pjesëve të betonuara të oborrit, xhamave e kornizave në dritare, inventarit, dyerve e të tjera.

Në kontekstin e sotëm, lidhja e tyre me shkollën reflektohet edhe nga brengosja e tyre për funksionimin e mëtejshëm të shkollës dhe për ruajtjen eventuale të vendit të punës. Për dallim prej mësimeve që rregullisht vijnë prej vendbanimeve të tjera, punëtorët e mirëmbajtjes zakonisht vijnë nga fshati ku funksionon shkolla. Kjo përbën lehtësi në kryerjen e punës së tyre, por edhe lidhje më të fuqishme me vazhdimin e funksionimit të shkollës në objektin e njëjtë. Një gjë e tillë bën që këta të jenë shumë të interesuar dhe të involvuar në çfarëdo zhvillimesh lidhur me shkollën përkatëse. Shpesh angazhimi i tyre nuk vërehet në mënyrë direkte gjatë bisedave e gjatë komunikimit për funksionimin e shkollave të vogla e të paraleleve të ndara, por ata janë shumë të pranishëm objektivisht.

Gjatë bisedave me ta, punëtorët e mirëmbajtjes rrallë e shprehin brengën e tyre lidhur me trendin demografik dhe rrezikimin e vendit të vet të punës. Ata janë, pa përjashtim, të sjellshëm dhe qëndrojnë anash duke ua lënë të tjerëve që të deklarojnë. Mirëpo, vërehet angazhimi i tyre diskret qoftë përmes mobilizimit të prindërve, mësimeve ose të nxënësve në drejtim të vazhdimin të funksionimit të shkollës. Për shkak të funksionit dhe lidhjes së tillë,

punëtorët e mirëmbajtjes gjatë procesit të hulumtimit për këtë raport kanë qenë hallkë e rëndësishme si në kuptim të informimit, por edhe të keqinformimit, të komunitetit lidhur me zhvillimet rreth shkollës.

Mësimi i nxjerrë: Rrjedhimisht, bëhet i domosdoshëm informimi, komunikimi dhe përfshirja e punëtorëve të mirëmbajtjes në të gjitha fazat dhe opsionet për rregullimin e kushteve dhe cilësisë së punës së fëmijëve që mësojnë në shkollat e vogla.

Prindërit:

Ligji për arsimin parauniversitar (neni 3.2.) i vendos prindërit në krye të entiteteve përgjegjëse për zbatimin e suksesshëm të arsimit parauniversitar. Domethënë prindërit janë përgjegjës për shkollimin e fëmijëve të tyre krahas me faktorët e tjerë, përfshirë autoritetet vendore dhe qendrore, jo vetëm arsimore. Për zbatimin e duhur të kësaj dispozite LAPU përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Prindërve si *“kanali kryesor i komunikimit dhe këshillimit mes Ministrisë, institucioneve arsimore e aftësuese dhe mes prindërve”*.

Gjatë vizitave në terren është konfirmuar rëndësia e prindërve për çfarëdo veprimi të rëndësishëm që ndikon në mbarëvajtjen e punës në institucionet arsimore në Kosovë. Intervistat me prindërit kanë treguar tri aspekte të rëndësishme të rolit të prindërve përkitazi me funksionimin e ShV dhe PN:

- Prindërit janë thellësisht të brengosur me trendin negativ të numrit të banorëve/fëmijëve, respektivisht nxënësve në komunitetin e tyre;
- Ata e njohin më së miri gjendjen dhe mundësitë që ofrohen përkitazi me ShV dhe PN në komunitetin/ zonën e vet;
- Ata kanë një qasje tradicionale dhe statike lidhur me misionin e shkollës dhe me karakteristikat e mësimi cilësor;
- Prindërit nuk janë të informuar sa duhet me trendet zhvillimore në arsim dhe as me nevojat për ristrukturim të rrjetit të shkollave.

Prezantim i rezultateve nga bisedat me prindërit

Siç është shënuar në pjesën e metodologjisë, në kuadër të studimit janë zhvilluar diskutime të fokusuara me katër grupe prindërisht të nxënësve të shkollave të vogla dhe të paraleleve të ndara. Mbase për shkak të natyrës së ndjeshme të temës së diskutimit, prindërit në këto diskutime kanë ardhur tejet të brengosur për fatin e shkollës së vet dhe biseda me ta nuk ka qenë aspak e lehtë. Pas analizës, del se një gjë e tillë ndodh si pasojë e mungesës së informimit të mirëfilltë, nga shkaku i keqinformimit nga persona që ndikohen nga funksionimi i shkollave të vogla, nga shkaku i komunikimit të gabuar të udhëheqjes së shkollave me komunitetin, dhe nga vetë pasiguria e përgjithshme që lidhet me trendin demografik dhe me rënien e vazhdueshme të numrit të fëmijëve/ nxënësve në këto zona.

Në vijim jepen disa nga elementët indikativë gjatë hulumtimit në mbështetje të konstatimeve të sipërpërmendura.

Në planin më të përgjithshëm, prindërit janë kryesisht të vetëdijshëm për rëndësinë e shkollës në arsimimin e fëmijëve. Mirëpo, prej të gjitha (14) shkollave të vizituara, vetëm prindërit e një shkolle e shohin shkollën të rëndësishme për zhvillimin e identitetit gjuhësor dhe për integrimin e fëmijëve në komunitet.¹⁷ Të tjerët, pothuajse pa përjashtim, e shohin shkollën si institucion ku fëmijët duhet të mësojnë. Të pyetur për funksionet e tjera të shkollës, pos mësim, ata deklarohen për rëndësinë e shkollës që nga koha e themelimit të saj, për gjeneratat që janë rritur e shkolluar aty, gjithashtu flasin për shkollën si tempull i dijes, dhe përmendin personalitete që janë shkolluar në atë shkollë e kohën kur shkolla ka qenë plotë me fëmijë, e të tjera. Mirëpo, interpretimet e tyre për rolin e shkollës mbasin të kufizuara në mësimdhënie e në të nxënë, duke lënë anash socializimin, zhvillimin fizik e psikik, mirëqenien e tyre, zhvillimin e talenteve, konkurrencën e dijes, ndërveprimin me fëmijët e tjerë, e të tjera.

Të pyetur për mundësinë e organizimit të **mësimi cilësor** në shkollën e tyre për shkak të numrit të vogël të nxënësve, ata theksojnë se mësimi është mjaft cilësor dhe insistojnë se nuk është më mirë as në shkollat e tjera në fshatrat përreth. Përderisa studime të shumta për arsimin në vendet e OECD-së (OECD f. 71) tregojnë se cilësia është kriteri kryesor i prindërve gjatë përzgjedhjes së shkollës në të cilën do të vijnë mësimin fëmijët, intervistat tona me prindërit nuk e shohin një tendencë të këtillë. Në këto biseda, kriter kryesor është ruajtja e shkollës – shpesh edhe në dëm të drejtpërdrejtë të mësimi cilësor¹⁸. Madje, ata shtojnë se për shkak të numrit të vogël të nxënësve, fëmijët në shkollat e vogla përfitojnë më shumë nga mësuesi i tyre. Disa prej tyre kujtojnë kohën, kur për shkak të numrit të madh të nxënësve në kohën kur ata ishin nxënës, shumica e nxënësve nuk përfitonin nga mësimi në klasë, pasi që nuk u vinte radha të lexonin apo të merrnin pjesë në diskutime në klasë. Po ashtu, prindërit mendojnë se numri i vogël ndihmon në kompensimin e mungesës së pajisjeve dhe laboratorëve. Për ilustrim, tregojnë ndonjë rast kur nxënësit e këtyre shkollave kanë fituar vende të dyta ose të treta në gara komunale.

Një qasje e tillë e prindërve të intervistuar korrespondon me gjetjet e hulumtimeve të ndryshme në vendet e OECD-së ku: *Edhe në rastet kur familjet e pafavorizuara kishin të drejtë për zgjedhjen e shkollave për fëmijët e tyre, atyre shpesh u mungonin njohuritë, mjetet, koha dhe kapitali social për të mbledhur informacione të mjaftueshme për cilësinë e shkollës* (Nusche 2009).

Të pyetur për **mungesën e punës në grupe dhe të konkurrencës së dijes** në klasë, prindërit pohojnë se këto janë mungesa të mësimi në shkollat e vogla, porse që kjo, megjithatë, sipas tyre, kompensohet nga puna e zellshme e mësuesve. Gjatë vizitave në klasat e shkollave të vogla ekipi hulumtues ka vërejtur se në pothuajse gjysmën e klasave mësuesit përdornin mjete të improvizuara konkretizimi për të ilustruar dhe konkretizuar përmbajtjen mësimore. Prindërit, po ashtu e pranojnë se mungon socializimi dhe ndërveprimi me më shumë fëmijë në shkollë dhe në shtëpi. Megjithatë, prapë insistohet se edhe nëse do të zhvendoseshin në ndonjë shkollë afër, nuk garantohet më shumë socializim as konkurrencë e dijes, pasi që, sipas tyre, popullata ka lëvizur në qytete gjithandej në zonat rurale. Prindërit reagojnë pozitivisht në ide të ndryshme të bashkëpunimit dhe bashkimit të nxënësve të shkollave të ndryshme për qëllime mësimi që të kompensohet mungesa e socializimit, krijimi i konkurrencës së dijes dhe përdorimi sado i kufizuar i pajisjeve/ mjeteve të konkretizimit.

17 Këtu ishte një komunitet që në shtëpi nuk flasin gjuhën shqipe dhe e shohin shkollën si vend të rëndësishëm për mësimin e kësaj gjuhe apo edhe si rrugë më e lehtë për integrimin e fëmijëve të tyre në jetë.

18 Për shkak të mungesës së kushteve themelore për mësim cilësor, përfshirë mungesën e pajisjeve mësimore, punës në grupe, mësimi me projekte, garës dhe konkurrencës së dijes.

Lidhur me **mungesën e pajisjeve, laboratorëve dhe mjeteve të konkretizimit**, ata fajësojnë autoritetet komunale dhe ato qendrore për mungesë të investimeve. Gjatë bisedave me prindërit, me mësimdhënësit dhe me drejtorët e shkollave vërehej një qasje tradicionale në kundërimin e cilësisë në arsim. Ata konsiderojnë se investimet në mjete e pajisje janë mënyra kryesore për sigurimin e cilësisë në shkollat e vogla. Prindërit e intervistuar nuk kanë ndonjë zgjidhje se si do të mund të bëheshin investime në shkollat e vogla në një mënyrë që kostoja të jetë e arsyeshme, për shembull sigurimin e një kabineti të biologjisë ose të kimisë për dhjetë nxënës të nivelit të mesëm të ulët. Mirëpo, ata insistojnë, që mbase në rastin e klasave të ulëta mund të sigurohen vetëm kompjuterë dhe mjete konkretizimi në vend se të sigurohen laboratorë të mirëfilltë. Për klasë më të larta (6-9), pajtohen që me qëllim të realizimit të kërkesave kurrikulare, nxënësit mund të dërgohen rregullisht (një herë në javë) në ndonjë shkollë më të madhe që i ka këto pajisje. Për këtë qëllim, ata mendojnë se transportin duhet ta sigurojnë rregullisht autoritetet komunale ose ministria.

Transporti

Përkritazi me transportin, prindërit në përgjithësi konsiderojnë se funksionon mirë dhe se paraqet ndihmesë të madhe për ta, sidomos në rastet kur nxënësit e klasave 6-9 transferohen në shkollë më të mëdha. Vërejtjet e tyre kryesore kanë të bëjnë me vonesat në nënshkrimin dhe fillimin e zbatimit të kontratave të transportit në fillim të vitit, ndonjë vonesë e mjeteve të transportit (sidomos pasditeve), pritja e nxënësve që mbarojnë mësimin më herët derisa të përfundojnë mësimin nxënësit e klasave që kanë më shumë orë, e edhe ndonjëherë gjendja e automjeteve që përdoren për transportimin e nxënësve, e të tjera. Në disa raste prindërit ankohen, që megjithëse vijojnë mësimin në paralele të ndara, nxënësit e vegjël shpesh duhet të kalojnë distanca prej më shumë se një kilometër e gjysmë të ngarkuar me çanta të rënda në zona të largëta (që përbëjnë rreziqe të ndryshme) dhe në kushte të rënduara atmosferike. Ata shtojnë se edhe përkundër funksionimit të shkollës së vogël, ata shpesh duhet t'i presin e përcjellin fëmijët në shkollë.

Gjatë diskutimit të zgjidhjeve të mundshme lidhur me transportin janë dhënë propozime të ndryshme, përfshirë organizimin nga shkollë të aktiviteteve plotësuese mësimore për nxënësit që presin deri sa të arrijë transporti, përkushtimin e qartë të kushteve për transportin e nxënësve, mbledhjen dhe shpërndarjen e fëmijëve nga ana e mjeteve të transportit shkollor sa më afër shtëpisë, organizimin e transportit për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta mësimore me nxënës të shkollave të tjera, organizimin e transportit edhe për shkollat e vogla, kur kushtet atmosferike janë të rënduara.

Klasat e kombinuara

Gjatë diskutimeve me prindërit u trajtua edhe çështja e mësimit dhe klasave të kombinuara. Duke menduar se po e mbronin institucionin (shkollën e vogël) nga mbyllja eventuale, një numër i madh i prindërve vazhdonin të mbronin edhe mësimin e kombinuar. Në këtë kupim thuhej se fëmijët edhe më parë kanë mësuar në klasë të kombinuara dhe kanë dalë të suksesshëm dhe mandej jepej ndonjë emër i ndonjë personi – ish nxënës – të suksesshëm nga zona e mbuluar nga shkollë. Gjatë diskutimit u prezantuan disa nga vështirësitë e punës në klasa të kombinuara, si për shembull interferimi i përmbajtjeve (matematikë dhe gjuhë amtare), shpërputhjet në nivelin e dijeve të zhvilluara (për shembull në të njëjtën kohë zhvillohen përmbajtje për klasat dy dhe katër), koha e shkurtër në dispozicion, mungesa e punës në grup, pritjet derisa t'i vijë radha njërit grup, komunikimi i vazhdueshëm njëkrahor me mësuesin, mungesa e të nxënësve të ndërsjellë (nga moshatarët) e të tjera. Prindërit vazh-

donin të insistonin se përkushtimi i mësuesve i kompensonte vështirësitë e shkaktuara nga mësimi i kombinuar. Kishte edhe propozime konstruktive si për shembull, mësimi ndaras i dy niveleve me orë të shkurtuara, ose organizimi i mësimit në bllok orë (një ditë matematikë, një ditë gjuhë e kështu me radhë) në grupe të ndara. Megjithatë, nga diskutimi dukej se mësimi i kombinuar nuk është trajtuar seriozisht as nga autoritetet as nga prindërit. Po ashtu, dukej se mësuesit, menaxhmenti i shkollës dhe autoritetet komunale nuk kanë punuar sa duhet për informimin e prindërve lidhur me këtë formë të mësimit.

Mësimi i nxjerrë: faktorët kryesorë arsimor në nivel vendor (shkollë dhe DKA) kanë qëndrim shumë tolerues ndaj mësimit të kombinuar dhe nuk janë të vetëdijshëm për shkallën e vështirësive që shkakton mësimi i kombinuar në zhvillimin arsimor dhe intelektual të fëmijëve. MASHTI duhet të nxjerrë vendime përkatëse për ngritjen e vetëdijes dhe ndërprerjen e formës së tillë të organizimit të mësimit në shkolla.

Si të përmirësohet gjendja:

Të gjitha grupet e fokusit me prindër janë pyetur edhe për mënyrën më të mirë të daljes nga situata e tanishme – në kuptimin e zhvillimit të mësimit në shkolla tejet të vogla dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Çështja trajtohej në dy mënyra nga prindërit. Në njërin anë vërehej qasja irracionale duke insistuar në ruajtjen me çdo kusht të shkollës së vogël përkundër të gjitha fakteve që flisnin të kundërtën, dhe në anën tjetër jepeshin propozime racionale për daljen nga situata. Në këtë të dytën, prindërit kryesisht kërkonin sigurimin e kushteve më të mira për mësim, rregullimin e infrastrukturës, sigurimin e transportit, eliminimin e padrejtësive ose të lëshimeve gjatë trajtimit të zonave/ shkollave të ndryshme, intervenime të përgjithshme të qeverisë në të gjithë sektorët (jo vetëm në arsim) për përmirësimin e kushteve të jetesës e të tjera. Po ashtu, jo rrallë, diskutoheshin zgjidhje të mundshme për fuzionimin e shkollave.

Në këtë kuptim propozohet që:

- Të organizohet mësimi në dy shkolla të vogla, ashtu që njëra organizon mësimin në nivelin fillor, e tjetra në nivelin e mesëm të ulët;
- Gjatë fuzionimit eventualet të merret parasysh ndjeshmëria e komuniteteve, për shembull nuk pëlqehet fuzionimi me shkollën në një fshat të afërm, por propozohet një fshat tjetër (ndonjëherë edhe më larg);
- Zgjidhjet eventuale të jenë cilësore dhe të qëndrueshme: një prind thoshte “Nëse nuk bëhet shumë më mirë, atëherë mos bëni lëvizje e tronditje për zgjidhje gjysmake; nëse na dërgoni në fshatin e afërm, edhe atje do të duhet të mbyllet shkolla pas një kohe të shkurtë.”;
- Të merren parasysh dhe të mos rrezikohet personeli i shkollës;
- Në rast të fuzionimit eventualet të rregullohet në mënyrë qëndrueshme çështja e transportit (derë më derë);
- Të mos ketë qasje të padrejtë dhe me preferenca politike në trajtimin e shkollave; e të tjera të ngjashme.

Përkatësia zonale:

Gjatë të gjitha bisedave me prindër është paraqitur një moment i ri lidhur me vendin e konsolidimit të shkollave në rast të fuzionimit të shkollës së tyre në një shkollë tjetër: pothuajse pa përjashtim, prindërit kanë qenë kundër fuzionimit në shkollën e fshatit/ fshatrave më të afërta. Argumenti kundër fshatrave të para/ të afërta ishte se gjendja në to nuk ishte më e mirë as për nga kushtet as për nga numri i nxënësve (në disa raste ishte edhe e kundërta); raportet me fshatin e afërt nuk ishin më të mirat të mundshme; fshati në distancë më të madhe (përmendeshin edhe emra konkretë) thuhej se ofronte kushte më të mira; distanca deri në shkollën amë shpesh ishte më e madhe dhe rruga më e papërshtatshme se sa distanca/ rruga në fshatin tjetër, e të tjera. Jo rrallë, kishte raste, kur theksohej se investimet në fshatin e parë më të afërt ishin bërë për motive politike, dhe jo për meritë dhe kjo kishte ndikuar në lënien pas dore të shkollës/ fshatit. Kjo ishte edhe shpesh arsyeja për refuzimin e integritimit me shkollën përkatëse.

Jo rrallë gjatë hulumtimit në terren, bashkëbiseduesit nga shkolla dhe komuniteti angazhoheshin në improvizime të ndryshme si përgatitja e fëmijëve për bisedë me hulumtuesit, insistimi që të jenë të pranishëm gjatë bisedës me fëmijët, dyshimi në sinqeritetin e ekipit hulumtues, insistimi në argumentet në favor të ruajtjes së shkollës me çdo kusht, paralajmërime për lëvizjen e popullatës në rast të mbylljes së shkollës, përkujtimin ekipit hulumtues për nevojën e ruajtjes së kufirit, e të tjera të ngjashme.

Mësimet e nxjerra:

- A** Prindërit duhen konsultuar në çdo rast për çfarëdo fuzionimi në mes të shkollave – ata i njohin shumë më mirë rrethanat e ndryshme që lidhen me historikun, raportet, të cilat ndikojnë në shkollën e realizimit të zgjidhjeve të caktuara.
- B** Duhet të organizohen aktivitete për vetëdijesimin e prindërve për rolin edukativo – arsimor të shkollës, krahas elementit socio-kulturor të saj.

Nxënësit

Pjesa më e vështirë gjatë tërë hulumtimit në terren ishin bisedat me nxënësit. Me apo pa qëllim, gjatë vizitës në këto shkolla, disi humbej rasti për të biseduar me nxënësit.¹⁹ Mikpritësit zakonisht e orientonin vizitën dhe bisedën larg nxënësve. Nga një duzinë shkollash të vizituara, hulumtuesit patën rastin të bisedojnë me nxënësit vetëm në tri shkolla.²⁰ Në një shkollë, takimi filloi me akuza të parapërgatitura ndaj ekipit hulumtues se kishte qëllim të manipulonte me nxënësit me qëllim që të mbyllej shkolla; në një rast tjetër, mësuesi dhe anëtarët e komunitetit insistonin që të jenë pjesë e bisedës me nxënësit; po ashtu, ndodhte që nxënësit të udhëzoheshin se çfarë të thoshin në bisedë me hulumtuesit, e të tjera.

Në bisedat e zhvilluara, nxënësit flisnin në mënyrë afirmative për shkollën, për mësuesit, për mësimin dhe kushtet e punës. Megjithatë, pyetjet plotësuese për socializimin, punën në grupe, punën laboratorike, pajisjet teknologjike, zhvillimin e projekteve, aktivitetet sportive, mësimin në klasë të kombinuara e të tjera mbeteshin kryesisht pa përgjigje. Krijohej përshtypja se në këto shkolla mungonte një spektër i tërë i aktiviteteve të jetës shkollore – pikërisht ato pjesë që ndikojnë në cilësinë e mësimin dhe në zhvillimin e fëmijës. Aspektet e munguara janë të lidhura kryesisht me madhësinë e shkollës (numri i nxënësve) dhe me pajisjet teknologjike dhe me mjetet e konkretizimit. Sipas nxënësve, rruga shtëpi-shkollë është një ndër

¹⁹ Duhet theksuar se të gjitha bisedat me nxënës janë zhvilluar me praninë e një personi të rritur nga shkolla ose nga komuniteti.

²⁰ Në shumicën e rasteve, mësimi kishte përfunduar para se ekipi të mbërrinte në shkollë. Sidomos në rastin e shkollave të dyta të vizituara gjatë ditës.

problemet e tyre; pastaj mungesa e fëmijëve të tjerë në shkollë dhe pamundësia që të krahasohen me fëmijë të tjerë. Një nxënës deklaroi që nuk e dinte se sa është i mirë në mësim pasi që nuk kishte më kë të krahasohej. Fëmijë të tjerë tregonin se nuk kanë mundësi të mësojnë me pajisje moderne, me kompjuter e me projektor. Transparenca, informimi dhe komunikimi paraqiten thelbësore në ndërveprimin me prindërit në trajtimin e dukurive në arsimimin e fëmijëve të tyre.

Rezultatet e vëzhgimit:


Përshtypja e parë, me të hyrë në një shkollë të vogël ose në një paralele të ndarë është mungesa e gjallërisë dhe zhurmës së fëmijëve në shkollë e në oborr. Përshtypje të tjera janë edhe lënia pas dore dhe zbrazëtia. Oborri i shkollës dhe ndërtesa nuk japin përshtypjen e “tempullit të dijes” dhe as që shërbejnë për motivim, për nxitje ambiciesh, ose për realizim dëshirash. Rrethoja e shkollës dhe porta janë zakonisht të dëmtuara dhe me ndreqje të improvizuara me materiale rrethanore. Bari është i pashkelur dhe mbulon tërë hapësirën e oborrit, përfshirë herë-herë edhe pjesët e betonuara, rrugicat dhe fushën e sporteve. Ndërtesa e shkollës është kryesisht e vogël dhe duket më e vjetër dhe më e amortizuar se që është realisht, për shkak të mungesës së përdorimit dhe përkujdesjes së rregullt. Xhamat e dritareve janë shpesh të dëmtuar dhe të rregulluar vetëm për aq sa është e domosdoshme që të pengohet depërtimi i elementeve atmosferike.

Mësuesit dhe nxënësit nuk dukej ta kishin ndjenjën e përkatësisë dhe të afërsisë me këto objekte. Një gjë të përshtypje të theksuar: këto shkolla punojnë sipas orarit të dy a tri paraleleve që janë aktive. Shkolla përfundon mësimin sapo të përfundojë orari i mësimi të paraleles së caktuar. Nuk vërehet mësim plotësues as qëndrim i mësuesve, i përgjegjësve ose i drejtorit të shkollës pas orarit. Përshtypja e lënies pas dore të këtyre shkollave forcohet edhe më me një tendencë të ikjes së mësuesve e nxënësve nga shkolla. Duket se rrallë (konkretisht 1 rast në 12 shkolla të vizituara) ndodh që të mbetet dikush më gjatë (në rastin konkret punëtori i mirëmbajtjes) duke u kujdesur për shkollën.²¹ Domethënë, në vend të një mjedisi të ngrohtë, pikë takimi, hapësire për aktivitete me fëmijë dhe me komunitetin, këto shkolla (pas orarit) i ngjajnë një objekti të braktisur nga njeriu.

Brendia e shkollës është e pastër dhe plotëson kërkesat themelore për pastërti në dysheme dhe në pjesët kryesore të hapësirave. Mirëpo, zakonisht mbesin hapësirat dytësore, këndet, muret, pjesët rreth stufave që do të mund të mirëmbaheshin më mirë. Brenga kryesore janë nyjat sanitare (që shpesh janë të vjetruara ose ndodhen jashtë objektit shkollor) dhe stufat, të cilat krijojnë një mjedis të pashëndetshëm me tym, pluhur, hi, copa të drurit dhe ashkla në dhomën e mësimi. Dhomat zakonisht ngrohen me stufa dhe me lëndë drusore. Materialet dhe mjetet për pastrim janë me gjasë të pamjaftueshme sepse (sidomos në korridore) vërehet përdorimi i bollshëm deri në teprim i ujit me qëllim kompensimi të mungesave. Në disa raste, disa dhoma mësimi janë të mbyllura për shkak të mos-përdorimit, si rezultat i rënies së shpejtë të numrit të nxënësve. Pjesët që nuk shfrytëzohen janë edhe më shumë të lëna pas dore dhe inventari është i thyer, dyert të dëmtuara dhe dritaret të rregulluara sa për të qenë të mbyllura. Një pjesë e inventarit mungon nga këto dhoma, sepse është përdorur në dhomat e tjera pas dëmtimeve dhe thyerjeve të inventarit të përdorur.

21 Nga 12 shkolla të vizituara, në katër raste shkollat/ paralelet e ndara kanë qenë të mbyllura (para mesditës) sepse të gjithë kishin shkuar në shtëpitë e veta menjëherë pas orarit.

Përshtypja e lënies pas dore të këtyre shkollave forcohet edhe më me një tendencë të ikjes së mësuesve e nxënësve nga shkolla.



Domethënë, në vend të një mjedisi të ngrohtë, pikë takimi, hapësire për aktivitete me fëmijë dhe me komunitetin, këto shkolla (pas orarit) i ngjajnë një objekti të braktisur nga njeriu.

Klasat janë rregullisht të vogla dhe vazhdimisht pa pajisje dhe, rrjedhimisht, nuk plotësojnë kërkesat për mësim cilësor. Inventari është në sasi dhe cilësi minimale: dërrasë e gjelbër/ zezë, karrige dhe banka të cilësive dhe formave të ndryshme, një stufë (ose vendi i stufës), dhe ndonjë dollap i dëmtuar. Pa përjashtim, nuk ka asnjë kompjuter, projektor, ose pajisje laboratorike në asnjërën prej shkollave të vogla / paraleleve të ndara. Në mure, plafon, dritare, dyer dhe në inventar vërehen rregullisht prishje të pa-trajtuara, mbase për një kohë më të gjatë. Për të shkruar në tabelë përdoren rregullisht shkumësat – edhe ata kryesisht vetëm në ngjyrë të bardhë.²² Muret e klasave janë zakonisht të ngjyrosura me ngjyra të çelura – por shpesh vërehet se nuk janë ngjyrosur një kohë të gjatë.

Në kontrast me këtë fotografi të zymtë të inventarit fare minimal, shpesh muret janë të mbuluara me punime të nxënësve, me ndonjë hartë, me fotografi, shkronja të punuara në letër e materiale të tjera, si dhe thënie të ndryshme për rëndësinë e arsimit. Tavolina e mësuesit është vendi ku kompensohen (brenda mundësive të mësuesve) mangësitë e sistemit për furnizimin e shkollave të vogla dhe paraleleve të ndara. Në tavolinë vërehen shkumësa e lapsa me ngjyra, mjete të improvizuara për punime të nxënësve, letër e bardhë, fletore, vizore, e mjete të tjera mësimore. Nga vëzhgimet e hulumtuesve dhe nga intervistat mësohet se këto mjete janë furnizime të vetë mësueseve. Edhe teknologjia e rrallë që haset gjatë kohës së mësimi, janë pajisje personale të mësueseve që punojnë në këto shkolla.

Në përgjithësi, shkollat e vogla nuk funksionojnë për nxënësit. Nga vëzhgimet e hulumtuesve, faktori i vetëm arsimor që u përkushtohet nxënësve janë mësuesit, askush tjetër. Nuk vërehet as angazhimi i prindërve, as i DKA-së dhe as i shkollës amë. Mësueset janë kryesisht të reja në moshë dhe në profesion.²³ Vërehej një rregull që në shkolla të vogla duhet të dërgohen personeli i ri dhe pa përvojë! Nga drejtoritë komunale nuk kishte ndonjë shpjegim për këtë dukuri. Mirëpo, ka të ngjarë që një paradigmë e tillë për caktimin e mësuesve të ketë prod-

²² Me pak më shumë kujdes, komuna mund të furnizonte shumë më mirë këto Shkolla.

²³ Nga 12 shkollat e vizituara, i gjithë personeli ishte në moshë të re, me përjashtim të ndonjë mësime dhënësi të gjuhës angleze. Përjashtim bënin edhe personeli i (paksa më i moshuar) i shkollave amë që kishin mbetur me numër (nën 50) tejet të vogël të nxënësve në katër a pesë vitet e fundit.

huan efektin më pozitiv (e mbase edhe efektin e vetëm pozitiv) përkitazi me cilësinë e mësimimit në këto shkolla! Mësueset e reja kishin përkushtimin dhe energjinë e duhur që të merren me sfidat e shumta të punës në shkolla të vogla. Ato përpiqeshin të krijonin një mjedis të ngrohtë në klasë, përdornin materiale të improvizuara, aplikonin qasje miqësore dhe metoda aktivizuese në punë me fëmijët. Mungesa e përkrahjes nga autoritetet e institucionet arsimore nuk reflektohej në entuziazmin, energjinë dhe në angazhimin e mësueseve të reja.

Megjithatë, duket se mësueset e shkollave të vogla të vizituara ende nuk kanë gjetur një zgjidhje për kompensimin e mungesave në socializimin e fëmijëve dhe për rregullimin e problemit me zhvillimin e mësimimit në paralelet e kombinuara. Domethënë, pa përkrahjen e duhur dhe në mungesë bashkëpunimi me kolegë të tjerë nga shkolla(t) e tjera, mësueset ende dukeshin të angazhuara për të kërkuar dhe aplikuar zgjidhje jashtë realitetit të ngushtë të shkollës. Domethënë, zgjidhjet për numrin e vogël të fëmijëve, për mungesën e pajisjeve të duhura laboratorike, për mungesën e teknologjive të reja në shkollën e vet duhet kërkuar atje ku janë – në shkollën amë ose në shkollat urbane. Për këtë qëllim duhet të angazhohen jo vetëm mësueset, por edhe drejtorja e shkollës.

Ndarja nga shkolla amë: Pikërisht këta të fundit, drejtorët e shkollave të vizituara, si duket nuk e shohin ende që kanë obligim të sigurojnë kushte të njëjta të mësimimit për të gjithë nxënësit e shkollës së vet – përfshirë paralelet e ndara. Socializimi, konkretizimi i mësimimit, laboratorët, puna në grupe të nxënësve, puna në projekte e të tjera mund të sigurohen me një qasje më kreative në sigurimin e mësimimit në nivel të shkollës amë ose edhe në nivel të komunës. Drejtorët e intervistuar të shkollave dhe drejtorët komunalë nuk treguan për raste të organizimeve të këtilla, me përjashtim të ceremonive të shënimit të Ditës së shkollës ose të ditëve të tjera të shënuara. Intervistat tregojnë se nxënësit e shkollave të vogla/ paraleleve të ndara shihen si një problem që do të zgjidhet vetëm me pushimin e veprimtarisë së shkollës.

Kushtet e përshkruara më sipër janë të reflektuara edhe në sjelljen e nxënësve të ShV/ PN. Të mësuarit për një kohë të gjatë në paralele të vogla ka bërë që këta fëmijë të jenë më të mbyllur, me më pak fjalë, dhe më pak dinamik. Në shkollat e vizituara mungon zhurma e fëmijëve, pushimet mes orëve janë të heshtura; në të vërtetë, pushimet në mes të orëve nuk vërehen edhe atëherë. Një gjë shumë shqetësuese gjatë tërë hulumtimit ishte se nxënësit ishin të defaktorizuar, sikur të mos ishin fare aty.

**Identifikimi
dhe diskutimi
i çështjeve
kryesore**

5

Në vijim prezantohen çështjet dhe problemet kryesore të identifikuar gjatë hulumtimit të organizuara në disa fusha kryesore: ligji, mirëqenia e fëmijëve, cilësia e shërbimeve arsimore, infrastruktura:

Zbatimi i mangët i dispozitave ligjore

Kushtet për themelimit, funksionim dhe shuarje të institucioneve edukative e arsimore të arsimimit parauniversitar trajtohen në dispozitat e Udhëzimit Administrativ MASHT 104/2020. Gjendja në terren në disa nga shkollat e vizituara tregon për mos-implementim të dispozitave në vijim të nenit 4 për kushtet e themelimit (dhe funksionimit) të një shkolle:

- Pika 4.1.1.: raportit mësimdhënës – nxënës nuk është në përputhje me standardin e MASHTI (MASHT 2013)
- Pika 4.1.3.: infrastruktura është nën çdo standard; mungojnë pajisjet, laboratorët/kabinetet, mjetet materiale; në të shumtën e rasteve objekti është në gjendje të mjerueshme për mungesë investimesh (Ministria e financave nuk lejon investime në shkollat me më pak se 100 nxënës); pa përjashtim, në të gjitha shkollat e vogla të vizituara, objekti është i lënë pas dore.
- Pika 4.1.4.: planprogramet mësimore janë në pajtim me kurrikulën, mirëpo zbatimi i tyre (në rrafshin e metodologjisë së mësimdhënies, vlerësimit, konkretizimit e të tjera) është objektivisht dhe praktikisht i vështirë.
- Pika 4.1.5. në ShV dhe PN nuk bëhen investimet e duhura, përkundër ekzistimit të mjeteve nga granti specifik për arsim. Financohen vetëm funksionet themelore (mësimdhënia, mirëmbajtja, ngrohja) por nuk financohen elementet që sigurojnë cilësinë).
- Pika 4.1.6.: ShV dhe PN nuk janë aspak rentabile nga aspekti ekonomik. Kostoja e mbajtjes së tyre është shumë më e lartë (mirëmbajtja, amortizimi, shërbimet komunale, raporti tejet i ulët mësimdhënës / nxënës) se efekti i tyre në shërbime cilësore arsimore (nuk plotësohet asnjë kusht për zhvillim të mësimit cilësor me qasje ndërvepruese, mësim në bashkëpunim, konkretizim të përvojave mësimore, mësim në laborator/kabinet, punë në projekte, përdorim të teknologjive moderne, e të tjera).
- Shumica e këtyre institucioneve janë në kundërshtim edhe me paragrafin 2 të nenit 4 lidhur me kriterin e numrit minimal për funksionim të shkollës/ paraleles së ndarë si për zonat e ulëta dhe në zonat malore e kufitare.
- Një numër i konsiderueshëm i këtyre shkollave do të duhej të trajtoheshin sipas nenit 9 të UA 104/2020 për pushimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore.

Megjithatë, mungesa më e madhe e këtyre shkollave nuk janë çështjet financiare, ekonomike, e materiale. Siç shihet nga prezantimi i rezultateve (4.1. më lart), problemi më i madh është mungesa e cilësisë dhe e mirëqenies së fëmijëve/ nxënësve në këto shkolla.

Në ShV dhe PN të vizituara nuk zbatohet as përafërsisht dispozita kushtetuese (Neni 47) për të drejtën në arsim: “Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta

për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj" (Kuvendi i Republikës së Kosovës 2008)²⁴. Fëmijët në shkollat e vogla nuk duket të kenë mundësi të barabarta për t'u arsimuar me ato të shkollave më të mëdha rurale dhe urbane; shërbimet arsimore në këto shkolla nuk janë në përputhje as me aftësitë e as me nevojat e fëmijëve në këto shkolla".

Shumë aspekte të funksionimit të shkollave të vogla duket të jenë në kundërshtim edhe me nenin 1.2.1. për qëllimet e arsimit parauniversitar (Kuvendi i Republikës së Kosovës 2011) ku theksohet *"zhvillimi i personalitetit, talentit dhe aftësisë mendore e fizike të nxënësit deri në potencialin e tij të plotë."* Në shkollat e vogla, mungon socializimi, mësimi ndërveprues, konkurrenca e dijes, dhe aspekte të tjera të cilat mundësojnë zhvillimin e plotë të potencialit dhe mirëqenies së fëmijëve.

Gjendja në shkollat e vogla është problematike edhe nisur nga dispozitat (Neni 37.2) e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve (Kuvendi i Republikës së Kosovës 2019): "Ministria përkatëse për arsim duhet të sigurojë qasje gjithëpërfshirëse dhe frekuentim të **arsimimit falas e cilësor**, në bazë të **mundësive të barabarta dhe pa diskriminim**, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar". Kjo dispozitë përcakton se MASHTI, (mbase në bashkëpunim me komunat) është i obliguar të sigurojë arsimim cilësor dhe kushte të barabarta të arsimit për të gjithë fëmijët, përfshirë ata në shkollat e vogla.

Dimensionet e rrezikuara

Organizimi i këtillë i mësimit në shkollat e vogla dhe në paralelet e ndara rrezikon dimensionet kryesore për të cilat organizohet mësimi:

Mirëqenia e fëmijëve:

- **Socializimi i fëmijëve:** Mungon plotësisht socializimi i fëmijëve. Nxënësit e SHV dhe PN bashkëpunojnë me fëmijë të tjerë vetëm me rastin e shënimit të ditëve të rëndësishme ose festave kombëtare. Edhe në këto raste nuk ka ndonjë qasje të integruar – ata janë kryesisht shikues në këto ngjarje. Nxënësit komunikojnë kryekëput me të njëjtit 2-3 fëmijë në shkollë dhe në shtëpi.
- **Presioni i madh intelektual:** fëmijët janë vazhdimisht (për 45 minuta) nën mbikëqyrjen e mësuesit dhe nuk mund të ruajnë fokusin për të përcjellë mësimin. Në bazë të teorive, fëmijët e moshës së re mund të rrinë të përqendruar rreth 7 deri 10 minuta. Për shkak të numrit të vogël kërkesat e mësuesve janë më të mëdha se kjo. Kjo shkakton lodhje të madhe dhe pasiguri te fëmija, pasi që mësuesi është pika e vetme e referimit dhe e krahasimit për fëmijën.

Cilësia e mësimi:

- **Konkurrenca e dijes:** mungesë e garës dhe e shkëmbimit të ideve e përvojave të të nxënësve. Për shembull, fëmijët deklarojnë që nuk e dinë asnjëherë se sa dinë, sepse nuk kanë me kë të krahasohen;
- **Mësimi monoton:** Për shkak të numrit të vogël të nxënësve (sidomos në klasat me mësim të kombinuar) mungojnë puna në grupe, mësimi ndërveprues dhe metodat atraktive të punës. Mësimi është kryesisht frontal dhe me detyra individuale të punës.
- **Klasat e kombinuara:** Mënyra e organizimit të mësimi në klasat e kombinuara nuk përputhet me asnjë nga format dhe teoritë moderne të zhvillimit të mësimi. Mësimi i zhvilluar në klasat e kombinuara duhet të llogaritet **në kohë të humbur** për fëmijët që kanë vijuar formën e tillë të të mësuarit.

Infrastruktura - kushtet e punës dhe të mësimi

- **Kushtet e punës dhe të mësimi:** mungojnë laboratorët, kabinetet, pajisjet teknologjike, madje nuk ka as kompjuter e projektor. Mungojnë edhe mjetet konkretizuese dhe materialet mësimore. Në këto shkolla nuk bëhen kurrfarë investimesh (nuk lejohen për shkollat me më pak se 100 nxënës).
- **Dallime të mëdha** deri në diskriminim – përkitazi me kushtet për zhvillimin e mësimi në mes të shkollave të zonave rurale dhe urbane të së njëjtës komunë. Për arsye të ndryshme, dallime vërehen edhe në mënyrën e trajtimit të shkollave në zonat e ndryshme rurale. Në komunat e vizituara mungon një qasje e standardizuar e krijimit të kushteve të barabarta të punës dhe të mësimi. Disa shkolla janë të reja dhe të pajisura mirë, ndërsa të tjerat (jo shumë larg këtyre) kanë mungesa të theksuara në furnizim me mjete materiale, pajisje, dhe kabinete / laboratorë.

Gjetje të tjera nga intervistat

Nga intervistat me prindërit dhe me faktorët e tjerë të organizimit të procesit mësimor në nivel të shkollave vërehet një dikotomi (dysi) ndërmjet rolit socio-kulturor dhe atij edukativ-arsimor të shkollës. Shpesh gjatë bisedave nuk vërehet ndarja në mes të rolit të shkollës si element i emancipimit të komunitetit (por edhe i garës me fshatin afër) nga roli i shkollës për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të atij komuniteti. Diskutimet në vijim trajtojnë këtë dikotomi dhe nevojën për përtëritjen e misionit edukativ - arsimor të shkollës në aktualitetin kosovar.

Komunat deklarohen të angazhuara që të zbatojnë udhëzimin e tanishëm të MASHTI për shkollat e vogla (104/2020), mirëpo (me ndonjë përjashtim të rrallë) nuk ka ndonjë qasje sistematike dhe të planifikuar për zbatimin e tij. Arsyetimet kryesore lidhen me reagimin e komunitetit, por nuk vërehen përpjekje të përkushtuara për adresimin e çështjeve.

Komunat nuk kanë rregullore të mirëfillta për organizimin cilësor të transportit të nxënësve në territorin e komunës. Aktualisht, për mbikëqyrjen e cilësisë së transportit të nxënësve, in-

spektorati dhe policia rrugore mbështeten në kushtet e shpallura në thirrjet për furnizim me shërbime transportuese. Mirëpo, këto rregulla janë kryesisht kushte teknike, që nuk parashohin sa duhet mbrojtjen e sigurisë, shëndetit dhe të mirëqenies së fëmijëve. MASHTI duhet të ndihmojë me vendosjen e një standardi në shkallë vendi.

Brengos tendenca e qartë e lënies totale pas dore të personelit dhe të nxënësve që punojnë dhe mësojnë në shkolla të vogla/ paralele të ndara.

Te mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të vogla dhe paraleleve të ndara vërehet pasiguria për fatin e shkollës, mungesa e gjallërisë së mjedisit mësimor, mungesa e zhurmës në oborr gjatë pushimeve, mungesa e aktiviteteve sportive e të tjera. Kjo ndikon dukshëm në zhvillimin dhe në formimin e fëmijëve. Mungesa e pajisjeve teknologjike vetëm sa e shton këtë atmosferë të ndrydhur. Shkollat e vogla funksionojnë në një realitet tjetër – pa optimizëm e gjallëri të fëmijëve.

Problemi i fshehur: Një shkollë me 70 nxënës që zhvillon mësimin në klasën parafillore dhe në nëntë klasë (0 - 9) nuk është në gjendje më të mirë se një shkollë me 20 nxënës që zhvillon mësimin në katër klasë (1-4). Përkundrazi, sa më shumë nxënës në shkollat e vogla (deri 150 nxënës) aq më i madh numri i fëmijëve të dëmtuar nga mungesa e arsimit, e edukimit dhe e socializimit cilësor. Edhe pse në suaza të ligjit (kriteri i numrit për shkolla të vogla në UA 104/2020), këto institucione i shkelin kriteret për sigurimin e cilësisë dhe për mirëqenien e fëmijëve.

**Praktikat
e mira:**

6

Praktikat e mira jashtë vendit

Në botë ka përvoja të ndryshme në përballje me këso trendi të rënies së numrit të nxënësve. Në disa raste, shtetet vendosin kriteret e licencimit të institucioneve arsimore, përkrahin bashkëpunimin në mes të shkollave duke u ofruar ndihmë në pajisje, menaxhim dhe administratë të disa institucioneve. Disa të tjerë krijojnë institucione të reja duke ofruar ndihmë për sektorin privat, e të tjera. Shembuj të tillë hasim në Komunitetin Flaman në Belgjikë, Danimarkë, Estoni, Lituani, Slloveni e të tjera. Disa vende kanë aplikuar një qasje më sistematike në konsolidimin e rrjeteve shkollore.

Norvegjia – Praktika me themelim të shkollave private të financuara nga shteti (sipas metodës Montessori) me rastin e kufizimit të rrjetit të shkollave dhe pamundësisë së ofrimit të shërbimeve arsimore në zonat ku është shënuar rënie e numrit të nxënësve (OECD 2018, 65).

Danimarkë: Autoritetet komunale në mënyrë të pavarur kanë zbatuar konsolidimin e rrjeteve të veta shkollore që të sigurohet ekonomi e shkallës (ang. economy of scale: ulje e kostos së veprimtarisë për njësi – në rastin konkret nxënës – pasi që shpenzimet fikse mbesin të njëjta), ulje e shpenzimeve në arsimin e mesëm të ulët duke organizuar mësimin në shkollë më të mëdha, si dhe rritje e performancës së nxënësve përmes përmirësimit të mjedisit të të nxënësve (Nusche 2009, 81). Midis viteve 2007 dhe 2013, për shembull, komunat daneze i janë përgjigjur zvogëlimit të numrit të grupeve/ nxënësve duke mbyllur shkollat më të vogla dhe duke riorganizuar menaxhimin e shkollave, ashtu që disa shkollë janë bashkuar nën të njëjtën udhëheqje. Si rezultat, ata arritën të reduktojnë numrin e përgjithshëm të shkollave komunale për më shumë se një të pestën dhe rritën madhësinë mesatare të një Folkeskole (shkollë publike fillore dhe të mesme të ulëta) nga 362 në 442 nxënës.

Republika e Çekisë: Në Çeki, komunat janë përgjegjëse për shkollat fillore, ndërsa rajonet janë përgjegjëse për funksionimin e shkollave të mesme të larta. Kur kishte filluar rënia e numrit të nxënësve, komunat kanë qenë në gjendje të përcjellin këtë trend duke pasur autorizimet e duhura për planifikimin e numrit të personelit dhe të rrjetit të shkollave. Njëkohësisht, formula e financimit e caktuar në nivel qendror dhe e bazuar në financim për numër të nxënësve, ofron edhe stimulime për konsolidimin (mbledhjen) e shkollave në njësi më të mëdha. Në anën tjetër, modeli i menaxhimit të shkollave dhe objekteve të ndryshme shkollore si një entitet juridik, ka lejuar funksionimin modular të shkollave dhe rialokimin e shërbimeve në mes të shkollave të ndryshme (Shewbridge 2016). Ky model do të mund të ndihmonte edhe në Kosovë (sidomos në zonat rurale), ashtu që investimet të organizohen në atë mënyrë që shkollat e një zone të bashkëpunojnë në përdorimin e resurseve dhe përparësive të veta. Në këtë rast, një shkollë do të kishte laboratorë të caktuar, tjetra pajisjet e teknologjisë informative, e treta do të ofronte sallën e sporteve, e të tjera. Kjo formë e bashkëpunimit do të kursente përsëritjen e investimeve të njëjta në tri a katër shkollë. Po ashtu, konsolidimi i menaxhimit të tri a katër shkollave do të mund të tejkalonte problemin e investimit në shkollë me më pak se 100 nxënës (për shkak të përdorimit të pajisjeve nga nxënësit e të gjitha shkollave të konsoliduara nën të njëjtin menaxhim).

Shtetet e Bashkuara të Amerikës: Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka një qasje origjinale në organizimin dhe trajtimin e rrjetit të shkollave. Në shtetet e SHBA i kushtohet rëndësi e theksuar transportit të fëmijëve/ nxënësve nga shtëpia në shkollë, sidomos jashtë zonave urbane.²⁵ Përmes sigurimit të transportit “nga dera e shtëpisë” është shtuar siguria e fëmijëve

25 Të gjithë i kemi parë autobusët e verdhë – si shenjë mbrojtëse – që shërbejnë për bartjen e nxënësve për në shkollë dhe nga shkollë në të gjitha shtetet e SHBA.

dhe është arritur një raport efikas nxënës/ shkollë (526), nxënës/ mësimdhënës (16)²⁶ dhe nxënës/ paralele (24)²⁷. Të gjitha këto shifra në vendin më të pasur në botë i tejkalojnë vlerat mesatare të Kosovës (vendi më i varfër në Evropë) ku gjejmë më pak se 300 nxënës për një shkollë, 17.3 respektivisht 20.1 nxënës për paralele dhe 13.5 nxënës për mësimdhënës. Duhet kujtuar se të gjithë indikatorët e përmendur në Kosovë kanë një tendencë negative prej rreth 3 % në vit. Nga kjo mësojmë se një rrugë e mundshme për përmirësim të këtyre indikatorëve është që Kosova të investojë më shumë për zhvillimin sistematik të sistemit të transportit të nxënësve. Mirëpo, për të realizuar një gjë të tillë, pos financimit, kërkohet edhe planifikimi dhe hartimi i kuadrit ligjor për komponentin e transportit të nxënësve/ fëmijëve në arsimin kosovar. Aktualisht, as në nivelin qendror as në komuna nuk ka një rregullore specifike për rregullimin e procedurave dhe kushteve për transportin e nxënësve në Kosovë.²⁸ Përderisa në Kosovë janë të rregulluara vetëm kushtet teknike të automjeteve, për bartjen e fëmijëve kërkohen kushte specifike për procedurat e transportit siç janë: siguria e fëmijëve dhe e automjeteve, përshkrimi i automjeteve, sjellja e pjesëmarrësve në proces para dhe gjatë transportit të fëmijëve, pritja e fëmijëve në shkollë dhe pas mësim, e të tjera.

Modeli i planifikimit të rrjetit shkollor nga UNESCO

Mekanizmat e monitorimit dhe të parashikimit luajnë rol thelbësor në konsolidimin e rrjetit shkollor në secilin vend dhe në krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve cilësore arsimore. Pa një mekanizëm të tillë autoritetet arsimore do të angazhohen në veprime afatshkurta dhe josistematike në menaxhimin e rrjetit të shkollave, siç ka ndodhur në Kosovë në periudhën e pasluftës. Kjo ka bërë që një numër i shkollave (sidomos në zonat urbane) të jenë të mbingarkuara, ndërsa një numër i madh i objekteve shkollore në zonat rurale mbesin të braktisura ose me numër fare të vogël të nxënësve.

Studimi i OECD-së për qeverisjen e rrjeteve shkollore vlerëson se “planifikimi strategjik i zhvillimit të infrastrukturës shkollore mbështetet në mekanizma efektivë të monitorimit e të parashikimit që mundësojnë qasje sistimore të bazuar në të dhëna të mjaftueshme dhe cilësore. Përmes tyre mund të caktohen prioritetet dhe të merren vendime për investime specifike. Në bazë të këtyre, politik-bërësit mund të realizojnë intervenime për rritjen e efikasitetit, bashkëpunimit në mes të shkollave, konsolidimit të rrjetit dhe zgjerimit e ndërtimit të objekteve të reja shkollore” (OECD 2018, 73).

Një nga mungesat më të mëdha lidhur me rrjetin shkollor në Kosovë është mungesa e qasjes sistematike dhe të planifikuar në reagimin ndaj trendit demografik, social dhe teknologjik në të gjitha nivelet e autoriteteve arsimore në Kosovë. Janë dy përpjekje në sistemin arsimor në Kosovë për një qasje sistematike: e para është krijimi i hartës së objekteve shkollore të bazuar në GPS (nga viti 2016)²⁹ dhe Politika e MASHTI-t **për trajtimin e shkollave me pak nxënës në Kosovë** (e vitit 2023).³⁰ Të dyja këto dokumente mund të përbëjnë bazë të mirë për përmirësimin e planifikimit të rrjetit shkollor në Kosovë. Një veprim i tillë do të siguronte edhe qasje më sistematike, pasi që do të ofronte **përkrahje për komunat në dimensionet**

26 Burimi OECD: <https://data.oecd.org/teachers/students-per-teaching-staff.htm>; hapur në gusht 2023

27 Burimi: <https://research.com/education/american-school-statistics#:~:text=The%20national%20average%20for%20the,ratio%20of%2016%20to%201>. Hapur në gusht 2023

28 Modele për rregullimin e transportit ka në dispozicion në vende të ndryshme. Për shembull rregulloret përkatëse nga shteti Gjorgjia në SHBA <https://www.gadoe.org/Finance-and-Business-Operations/Pupil-Transportation/Pages/Electronic-Form-Guides.aspx>.


29 Ky dokument përfshin një skicë digjitale të vendndodhjes dhe karakteristikave kryesore të secilit objekt shkollor në Kosovë. Dokument i papublikuar, MASHT 2016.

30 Dokument i papublikuar i MASHTI që përbën një Analizë koncize të gjendjes së shkollave të vogla dhe të paraleleve të ndara, dhe një Udhërrëfyes për konsolidimin e rrjetit të shkollave në Kosovë. Ky dokument nënkupton qasjen proaktive të komunave në trajtimin e çështjes së ShV dhe PN.

kryesore që u mungojnë atyre: të dhënat dhe ekspertiza për vendimmarrje të bazuar në informata. Dokumenti i dytë (Politika), ka shërbyer për të informuar punën e grupit punues të MASHTI në përkrahje të komunave për trajtimin e trendëve negativë demografikë dhe për konsolidimin e rrjetit të shkollave (në nivel komunal) në arsimin fillor e të mesëm të ulët në Kosovë.

Në këtë kontekst, Kosova do të mund të përfitonte shumë nga një aplikacion i zhvilluar nga UNESCO me qëllim të lehtësimit të qasjes së planifikuar për zhvillimin e arsimit. Ky model simulues i planifikimit strategjik bazohet kryekëput në të dhënat/ trendët demografikë dhe në resurset në dispozicion që të lehtësohet planifikimi i intervenimeve në arsim. Në këtë aplikacion, caqet e regjistrimit të nxënësve shërbejnë si bazë (variabël i pavarur), ndërsa inputet (resurset dhe fondet) e përdorura për arritjen e tyre shihen si reagim i autoriteteve për arritjen e tyre. Pasi që bazohet në modelin demografik, ky aplikacion është shumë i përdorshëm edhe për planifikimin e rrjetit shkollor.

Figura 1. në vijim prezanton shkurt elementet kryesore të këtij aplikacioni:



Siç tregohet në Figurën 1.1, EPSSim llogarit prurjet e projektuara, normat e regjistrimit dhe të prurjeve në bazë të të dhënave të popullsisë e të gjitha këto në kontekstin e opsioneve të politikave të lidhura me regjistrimin. Numri pasues i regjistrimeve sipas nivelit dhe llojit të arsimit, i kombinuar me modalitetet aktuale dhe të ardhshme të shfrytëzimit të burimeve (personeli mësimor, pajisjet, infrastruktura, etj.), mundësojnë gjenerimin e vlerësimeve të kërkesave të ardhshme për mësimdhënës, personel joarsimor, materiale mësimore, objekte shkollore e të tjera. Këto kërkesa të projektuara, së bashku me parametrat e të dhënave të shpenzimeve të kërkuara, tregojnë nevojat dhe boshllëqet e mundshme financiare për arritjen e objektivave të politikave arsimore (UNESCO 2005).

Parapëlqehet që në Kosovë këtë model ta aplikojë MASHTI në përkrahje të komunave, pasi që për realizimin e projeksioneve të gjeneruara nga ky aplikacion (model simulues) kërkohet ekspertizë dhe bazë solide e të dhënave të cilat nuk janë në dispozicion të komunave. MASH-TI do të mund të angazhonte ekspertizë të jashtme për përdorimin e këtij aplikacioni deri në ndërtimin e kapaciteteve të veta për planifikim të qëndrueshëm të resurseve arsimore dhe të rrjetit të shkollave në Kosovë.

Praktikat e mira në Kosovë:

Komunat mund të mësojnë shumë nga njëra-tjetra. Në secilën komunë të vizituar në kuadër të hulumtimit janë hasur probleme, por edhe strategji origjinale në përgjigje të atyre problemeve. Në ndonjë rast vërehet qasje më proaktive dhe më e pavarur e komunave, siç janë Drenasi, Gjakova dhe Istogu. Në të tjerat ka ndikuar pozitivisht nisma e jashtme e MASHTI-t për konsolidimin e rrjetit të shkollave (2022-2023). Në vijim jepen disa shembuj të mirë nga komunat e vizituara.

Një komunë, me vendosmëri, me planifikim të mirë të transportit dhe me investime në transport ka arritur të konsolidojë rrjetin e shkollave duke i shkrirë paralelet e ndara/ shkollat e vogla në atë komunë. Rolin kryesor këtu e ka bartur vendosmëria e udhëheqjes së komunës.

Një komunë tjetër, me qasje të planifikuar, me punë sistematike me komunitetin dhe me investime në transport ka arritur të fuzionojë shumicën nga shkollat e vogla ose nga paralelet e ndara gjatë viteve 2022-2023. Barrën kryesore në këto veprime e kanë bartur DKA-ja dhe drejtorët e shkollave amë. Në të vërtetë, duket se edhe në këtë segment të veprimtarisë arsimore, drejtorët e shkollave janë hallka më e qëndrueshme për punë me komunitetin.

Dy a tri mësuese në shkollat e vizituara, në bashkëpunim me mësues të tjerë, i kanë bashkuar fëmijët e shkollës së vogël me ata të shkollës më të madhe. Fëmijët kanë qenë të impresionuar. Raste të tilla në shkollat e tjera ndodhin vetëm me rastin e shënimit të Ditëve të shkollës ose datave të rëndësishme. Mirëpo, këto mësuese i kanë bashkuar nxënësit me qëllim të përdorimit të teknologjive dhe për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta mësimore.

Një arsimtare e muzikës në një shkollë organizon mësim praktik dhe ndërveprues me fëmijët. DKA e përkrah punën e saj për krijimin e kushteve të njëjta të mësimit edhe në paralelet e ndara ku ajo punon për plotësimin e normës. Ky ishte një shembull kur praktikrat e mira – mësimdhënia atraktive e ndërvepruese ofrohet me përkrahjen e autoriteteve komunale arsimore. Për organizimin e këtyre nismave të mira janë të domosdoshme elemente si: sigurimi i transportit, i mjeteve materialeve, i lejes për organizimin e aktiviteteve, i pajisjeve teknologjike (në rastin konkret një instrument dhe një CD-player). Bashkëpunimi në mes të shkollave përmban në vete potencial të konsiderueshëm (të pashfrytëzuar) për përmirësimin e cilësisë së mësimit në shkollat e vogla.

Një mësuese e një shkolle, paralele e ndarë në fshatin Surdull kishte krijuar kushte për mësim duke improvizuar materialet mësimore me mjete të ricikluara (për këtë shih më shumë tek seksioni Intervistat – Mësimdhënësit). Zgjidhjet e mësueses ishin të tilla që mundësonin të nxënë të qëndrueshëm dhe personalizim të përvojave të të nxënës. Sigurimi i përkrahjes më të madhe dhe replikimi i qasjes së mësueses (përmes bashkëpunimit dhe trajnimeve) do të ndihmonte në rritjen e cilësisë në shkollat e vogla me investime fare të vogla.

**Konkluzionet dhe
rekomandimet:**



Konkluzionet:

Nga gjetjet e hulumtimit për këtë studim, gjendja në Shkollat e Vogla dhe në paralelet e ndara në Kosovë është më e rëndë se që mendohet. Problemet në ShV dhe PN janë shumëdimensionale:

- Me disa përjashtime³¹, në nivel komunal nuk ka ekspertizë të nevojshme, as qasje sistematike e të planifikuar për t'u ballafaquar me problemin e ShV dhe PN. Zakonisht, qasja është fragmentare dhe intervenimet ndodhin vetëm në rastet kur ato bëhen të domosdoshme. Kryesisht, komunat tregojnë përkushtim, por edhe presin ndihmën e MASHTI-t për trajtimin e çështjeve të rrjetit të shkollave dhe të shkollave para shuarjes, si shkak i rënies së numrit të nxënësve. Komunat më aktive do të mund të shërbenin si model i trajtimit të problemit të shkollave të vogla.

- Kryesisht, në bazë të informatave të mbledhura nga hulumtimi, në shkollat e vogla nuk realizohen të drejtat në vijim:

- e drejta për arsimim cilësor,
- e drejta për zhvillimin e fëmijës në bazë të nevojave dhe mundësive të tij/saj,
- e drejta për zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijës,
- me gjasë, për shkak të mungesës së socializimit dhe komunikimi i vazhdueshëm vetëm me një mësimdhënëse, mund të mos realizohet as mirëqenia³² e plotë psikike e fëmijëve në shkollat e vogla.

Në bazë të një analize të MASHTI³³ "62 shkolla amë nuk i plotësojnë kriteret e Udhëzimit Administrativ 104/200 për të funksionuar si të tilla, ndërsa nga 187 paralele të ndara të shqyrtuara, 72.7% nuk i plotësojnë kriteret." Numri i shkollave që nuk plotësojnë kriteret duhet të jetë më i madh, pasi që nuk janë shqyrtuar të gjitha (254) paralelet e ndara në arsimin kosovar.

- Në parim, autoritetet komunale deklarohen në favor të zbatimit të dispozitave të UA 104/2020, mirëpo nuk kanë qasje të planifikuar dhe të qëndrueshme për trajtimin e problemeve. Një numër i madh i shkollave të vogla funksionojnë në shkelje të dispozitave të këtij Udhëzimi.
- Mungesa më e madhe në funksionimin e shkollave të vogla është **mungesa e kushteve për punë dhe për mësim cilësor**. Fusha e cilësisë në mësim është përgjegjësi e përbashkët e MASHTI-t dhe e komunave. MASHTI është i obliguar të ndihmojë komunat (nëpërmjet të politikave dhe akteve normative) në sigurimin e cilësisë dhe kushteve të barabarta për mësim për të gjithë fëmijët.
- Përkushtimi i mësimdhënësve dhe i fëmijëve janë elemente të rëndësishme pozitive në shkollat e vizituara.

31 Në dy nga gjashtë komunat e vizituara vërehet qasje më e planifikuar dhe më sistematike në trajtimin e problemeve të shkollave të vogla e paraleleve të ndara.

32 Neni 35.4.3 i Ligjit për të drejtat e fëmijëve

33 Politika e MASHTI për trajtimin e shkollave me pak nxënës në Kosovë, dokument i papublikuar, MASHTI dhjetor 2022.

Rekomandimet

MASHTI dhe komunat duhet të ndërtojnë një konsensus për konsolidimin e rrjetit të shkollave përmes një qasjeje sistematike dhe të planifikuar. Lidhur me zbatimin e qasjes së duhur në trajtimin e çështjes së rrjetit të shkollave në kontekstin e trendit negativ demografik (rënies së numrit të nxënësve), studimi i OECD-së për rrjetin e shkollave sugjeron se “Pa marrë para se a bëhet planifikimi dhe koordinimi i zhvillimit të rrjetit të shkollave nga niveli qendror, rajonal, apo lokal, duhet të kuptojmë se suksesi i autoriteteve në plotësimin e nevojave vendore varet nga një proces i mirëfilltë social i konsultimeve dhe shqyrtimeve të përbashkëta. Ky proces, duhet të bëjë përfshirjen aktive të hisedarëve, në vend se të shndërrohet në një proces kryekëput teknik e administrativ” (OECD 2018, 99). Në Kosovë kemi qenë dëshmitarë të dështimit të reformave të rrjetit shkollor në raste kur është aplikuar qasja administrative pa pjesëmarrje aktive të prindërve e të komunitetit. Edhe nismat me qëllimet më të mira dështojnë në kontekste të zbatimit administrativ. Qasjet e tilla administrative e teknike jo vetëm që kanë dëmtuar nxënësit, por kanë dëmtuar relacionet e niveleve të ndryshme të autoriteteve arsimore duke krijuar precedentë negativë edhe për konsolidim të rrjeteve në mjediset e tjera.

Në vijim jepen disa sugjerime³⁴ kryesore sipas nivelet të organizimit të autoriteteve arsimore:

Nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kërkohet:

Ndërtimi i kapaciteteve në nivelet përkatëse të vendimmarrjes për planifikimin e rrjetit të shkollave të bazuar në bazë të besueshme të të dhënave. Këtu do të duhej punuar për avancimin e aplikacionit të MASHTI (Harta Shkollore) për objektet shkollore nga viti 2016³⁵.

Përkrahje e DKA-ve për monitorimin, vlerësimin dhe planifikimin e rrjetit të shkollave në komunat përkatëse (shih modelin e UNESCO-s në 6.1. më lart).

Përkrahje DKA-ve në rrafshin horizontal për koordinimin e ndërsjellë të aktiviteteve dhe shkëmbimin e përvojave për monitorimin, vlerësimin dhe planifikimin e rrjetit të shkollave.

Rishikim i Rregullores për financimin e shkollave me qëllim të ngritjes së investimeve në shërbime e mallra dhe shpenzime kapitale, dhe përfshirjes së paraleleve të ndara në kriterin 1500/3250 euro për shkollë.

Në mungesë të kapacitetit të mjaftueshëm të DKA-ve, hartimi i qasjes fleksibile të centralizimit të qeverisjes së rrjetit të shkollave (OECD 2018, 99).

(Si institucion përgjegjës për sigurimin e cilësisë, nga MASHTI kërkohet) Hartimi dhe miratimi i politikës për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve arsimore përmes *kon-solidimit të rrjetit të shkollave – për të përfshirë edhe shkollat prej 50 deri 100 nxënës në një afat trevjeçar*.

34 Në rekomandime janë integruar edhe rekomandimet përkatëse nga studimi i OECD-së për “Sistemet e Përgjegjshme Arsimore” OECD 2018.

35 Aplikacion i MASHTI i përfunduar në vitin 2016 për vendndodhjen dhe karakteristikat e të gjitha shkollave në Kosovë - aplikacioni nuk është i publikuar.

Hartimi i politikës/ udhëzimit administrativ për standardizim (caktimin e nivelit minimal) të kushteve për mësim, përfshirë në mënyrë specifike për themelimin e shkollave të reja dhe për shkolla të vogla/ paralele të ndara.

Hartimi i udhëzimeve pedagogjike – metodologjike për zhvillimin e mësimi në paralele të vogla përfshirë eliminimin e mësimi në klasë të kombinuara.

Standardizimi (udhëzues ose normativ) i kushteve të transportimit të nxënësve në shkallë vendi si dhe caktimi i një fondi të veçantë për përmirësimin e kushteve të transportit të nxënësve. Në botë ka përvoja të mira në këtë kuptim.

Financimi i projekteve me aktivitete kurrikulare dhe jashtëkurrikulare me përfshirje të fëmijëve nga shkollat e vogla në shkallë nacionale: kampe teknologjike, gara në lëndë të ndryshme, projekte të përbashkëta në mes të shkollave, koloni të artistëve të rinj, kampe të vëzhguesve, aktivitete në klube e të tjera.

Nga Drejtoritë Komunale të Arsimit – Komunitat kërkohet:

Të angazhohen në shkëmbimin e ndërsjellë të sfidave, sukseseve dhe përvojave.

Të tregohen më të vendosura për zbatimin e politikave për konsolidimin e rrjetit të shkollave për të mirën e nxënësve duke lëvizur përtej trajtimit të pabarabartë dhe parapëlqimeve në përkrahjen e shkollave individuale.

Menaxhimi më i mirë i procesit dhe planifikimi afatmesëm për konsolidimin e rrjetit të shkollave.

Hartimi dhe zbatimi i politikës për standardizimin e shërbimeve arsimore në të gjitha shkollat në Komuna që të shmanget pabarazia në kushte dhe shërbime arsimore në mes të shkollave në të njëjtën komunë. Një qasje e mundshme do të ishte investimi i konsoliduar me pajisje dhe laboratorë/ kabinete në një të tretën e shkollave në komunë dhe mandej organizimi dhe bashkëpunimi i grupeve të shkollave në organizimin e aktiviteteve mësimore në ato hapësira dhe me ato pajisje.

Të mundësojnë që të gjithë fëmijët të gëzojnë të drejtën për mësim ndëreveprues dhe tërheqës, për punë në laboratorë e në kabinete, për mësim me pajisje dhe teknologji të reja, për garë dhe konkurrencë të dijes – PA MARRË PARA SYSH MADHËSINË E SHKOLLËS. Komunitat (me ndihmën e MASHTI-t) **duhet të sigurojnë kushte të barabarta** për mësim.

Organizimi i mësimi – së paku një herë në javë – në kushte kabinetike, me teknologji të reja, punë në grupe, punë praktike, punë me mjete konkretizimi e të tjera, brenda objektit shkollor ose jashtë tij (në një shkollë tjetër) për të gjithë nxënësit në komunën përkatëse.

Ndërprerja e menjëhershme e mësimi në klasat e kombinuara. Sugjerohet puna me vetëm një grup në një termin – qoftë edhe me orar të shkurtuar (2 orë të plota ose katër orë nga 25 minuta).

Komunat duhet të lejojnë qasje më fleksibile në planifikimin e zonave të gravitimit dhe investimet të shkojnë pas nxënësve në shkollat që krijojnë kushte më të mira mësimi. Kjo qasje duhet të plotësohet me sigurimin dhe zbatimin e një standardi minimal të kushteve të mësimi në të gjitha shkollat (shih më lart).

Komunat duhet të lehtësojnë aktivitete të përbashkëta MËSIMORE në mes të nxënësve të shkollave të ndryshme me pjesëmarrje të mësimdhënësve dhe të nxënësve nga shkollat e vogla/ paralelet e ndara që të sigurohet socializim dhe mësimdhënia tërheqëse për fëmijët e këtyre shkollave. Kjo duhet të bëhet së paku një herë në javë deri sa të bëhet një zgjidhje më e qëndrueshme e problemit të socializimit dhe mësimi ndërveprues. Kjo nuk nënkupton vetëm shënimin e ditëve festive – por aktivitete mësimore. Në botë ka shembuj të mirë të organizimit të një grupi të shkollave të cilat përfitojnë edhe investimet përkatëse në pajisje dhe aktivitete mësimore.

Të hartojnë rregullore të mirëfillta të procedurave dhe kushteve për transportin e nxënësve.

Financimi i projekteve me aktivitete kurrikulare dhe jashtëkurrikulare me përfshirje të fëmijëve nga shkollat e vogla në nivel të komunës/ rajonit: kampe teknologjike, gara në lëndë të ndryshme, projekte të përbashkëta në mes të shkollave, koloni të artistëve të rinj, kampe të vëzhguesve, aktivitete në klube e të tjera.

Drejtorët e shkollave:

Duhet të trajtojnë nxënësit e mësimdhënësit e paraleleve të ndara njësoj sikurse nxënësit e shkollave amë. Nëse nuk ka kushte për mësim në paralelen e ndarë, nxënësit duhet të përdorin infrastrukturën e shkollës amë së paku një herë në javë. Nëse edhe shkolla amë nuk ka kushte, drejtori i shkollës duhet të bashkëpunojë me shkollat e tjera dhe me DKA që të sigurojë që fëmijët e shkollës e të PN të kenë qasje në kabine, laboratorë, mjete konkretizimi, pajisje teknologjike së paku një herë në javë. Zgjidhjet e tilla duhet të vazhdojnë deri në zgjidhjen e përhershme, përkatësisht derisa të krijohen kushte optimale të punës e të mësimi.

Me qëllim të socializimit, duhet të organizohen aktivitete mësimore të përbashkëta (jo vetëm shënimin e festave kombëtare) së paku një herë në javë. Aktivitet profesional, mësimdhënësit dhe menaxhmenti i shkollës janë përgjegjës për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të tilla së paku një herë në javë.

Përfshirja e mësimdhënësve/ nxënësve të paraleleve të ndara në të gjitha organet dhe trupat e shkollës: këshilli drejtues, këshilli i prindërve, këshilli i nxënësve, aktivitet profesional, komisionet dhe grupet punuese të shkollës.

Vështirësitë e hulumtimit

Përkundër disa përjashtimeve, në të gjitha nivelet vërehet një prirje për improvizime me qëllim të ofrimit të një fotografie “të zbukuruar” të situatës me rastin e realizimit të vizitave në shkollat e caktuara (ndonjëherë organizohet shmangia e qëllimshme e ndonjë shkolle). Shpesh jepet një itinerar i vizitave që promovon shkollat e mira dhe fsheh problemet me numër, pajisje të shkollave dhe me cilësi në shkollat e tjera. Shkollat paralajmërohen paraprakisht për vizitën dhe pastaj krijohet një situatë e improvizuar që nuk përkon me kushtet dhe gjendjen aktuale. Kjo tregon mungesë përkushtimi për zbatimin e themeltë të politikave relevante në interes të nxënësve. Vështirësi të veçanta hasen në komunikim me nxënësit e shumicës së shkollave pasi që (me disa përjashtime) vërehet një tendencë e qartë që të ndikohet te nxënësit të promovohet një agjendë, e cila jo gjithmonë përkon me interesat e fëmijëve. Rrjedhimisht, duhet vazhduar me hulumtim më të mirëfilltë të perceptimeve dhe pikë-vështrimeve të nxënësve dhe të prindërve.

Bibliography

- Agjencia e Statistikave e Kosoves. 2023. *Statistikat Arsimore 2022-2023*. Prishtina: ASK. <https://ask.rks-gov.net/media/7552/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2022-2023.pdf>.
- Agjencia e Statistikave e Kosoves. 2013. *Statistikat e Arsimit 2012-2013*. Prishtina: ASK, 20. Qasja July 2023. <https://ask.rks-gov.net/media/1650/statistikat-e-arsimit-2013-2014.pdf>.
- Atkinson, Mary. 2005. *School funding - review of existing models in Europe and OECD countries*. London: The National Foundation for Education Reforms. doi:10.2797/08384.
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. 2022. *Aktgjykim 1977/22 - Vlerësim i kushtetutshmerisë së Vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/24, të 23 prillit 2021*. Prishtina: Gjykata Kushtetuese. https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2022/04/ko_145_21_agj_shq.pdf.
- Kuvendi i Kosovës. 2023. *Ligji 08/L-196 për pagat në sektorin publik*. Prishtina: Gazeta Zyrtare e RKS. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68695>.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*. Prishtina: Gazeta e RKS. https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se_Kosoves.pdf.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2011. *Ligji 04/L-32 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës*. Prishtina: Gazeta Zyrtare e RKS. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2019. *Ligji nr 06/ L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës*. Prishtina: Gazeta e Republikës së Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. *Ligji numer 03/L-040 për qeverisjen lokale*. Prishtina: Gazeta e Republikës së Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>.
- MASHT. 2016. *Korniza për sigurim të cilësive të performancës së institucioneve arsimore*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Qasja Maj 2023. *Korniza-për-sigurim-te-cilesise-se-performances-se-shkolles-ne-Kosove-2016.pdf* (rks-gov.net).
- MASHT. 2012. *UA 11/2-12 kriteret për licencimin e institucioneve arsimore private për nivelin fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë dhe institucioneve aftësuese profesionale*. Prishtina: MASHT. <https://masht.rks-gov.net/ua-kriteret-per-licencimin-e-institucioneve-arsimore-private-per-nivelin-fillor-te-mesem-te-ulet-dhe-te-mesem-te-larte-dhe-institucioneve-aftesuese-profesionale-11-2012/>.

- MASHT. 2013. *UA 22/2013 Numri maksimal i nxenesve per klase dhe raporti mesimdhenes - nxenes*. Prishtine: Gazeta zyrtare e RKS. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10018>.
- MASHT. 2016. *Udhezimi Administrativ per licencimin e institucioneve arsimore dhe aft-esuese te arsimit profesional*. Prishtina: Gazeta Zyrtare e RK. Qasja May 2023. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15135>.
- MASHT. 2015. *Udhezues per normat dhe standardet e ndertesave shkollore*. Prishtina: Gazeta Zyrtare e RKS. UDHËZUES PËR NORMAT DHE STANDARDET E NDËRTESAVE SHKOLLORE - MASHT (rks-gov.net) .
- MASHTI. 2023. *Udhezimi Administrativ 10/2023 për kriteret dhe procedurat për themelimin dhe pushimin e veprimtarisë së shkollës*. Prishtina: MASHTI. <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-10-2023-per-kriteret-dhe-procedurat-e-themelimit-dhe-pushimit-te-veprimtarise-se-institucioneve-te-arsimit-parauniversitar/>.
- McGee, John. 2014. *Wiley Encyclopedia of Management*. 3rd edition Vol 12 Strategic Management. Hoboken, New Jersey: John Wiley and Sons. doi:Vol 12 Strategic Management.
- Ministria e Financave. 2010. *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013*. Prishtina: Gazeta Zyrtare e RKS. Microsoft Word - KASH 2011-2013 SHQIP 27.08 2010.doc (rks-gov.net).
- Ministria e Financave. 2022. *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023 - 2025*. Prishtina: Gazeta Zyrtare e RKS, 81-82. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/B914D8CF-6E32-4074-A306-456E77A0457A.pdf>.
- Ministria e Financave. 2022. *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-3025*. Prishtina: Gazeta Zyrtare e RKS. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/B914D8CF-6E32-4074-A306-456E77A0457A.pdf> .
- Nusche, Deborah. 2009. *What works in Migrant Education*. Paris: OECD Publishing, 314. Qasja July 2023 18, 2023. https://www.oecd-ilibrary.org/education/what-works-in-migrant-education_227131784531.
- OECD. 2018. *Responsive School Systems - Connecting Facilities, Sectors, and Programmes for Student Success*. OECD Reviews, Paris: OECD Publishing, 78. Qasja July 2023. <https://www.oecd.org/publications/responsive-school-systems-9789264306707-en.htm>.
- 2019. *Working and Learning Together: Rethinking Human Resource Policies for Schools*, OECD. Paris: OECD Publishing. Qasja August 2023. <https://doi.org/10.1787/b7aaf050-en>.
- 2018. *Responsive School Systems: Connecting Facilities, Sectors and Programmes for Student Success*. Paris: OECD Publishin, 32. Qasja July 2023. doi:<https://doi.org/10.1787/9789264306707-en>.

- Shewbridge, Claire, et al. 2016. *Governance of schooling and the school network in the Czech Republic* - *OECD Reviews of School Resources: Czech Republic*. Paris: OECD Publishing, 68. Qasja August 2023. doi:doi.org/10.1787/9789264262379-en .
- UNESCO. 2005. *Education Policy and Strategy Simulation Model - EPSSIM*. User's Guide , Paris: UNESCO, 6. <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/publications/User%20Guide%20Education%20Policies%20and%20Strategies.pdf>.

Burime të tjera:

- Kornizat afatmesme të shpenzimeve 2011, 2013, 2016, 2019, dhe 2023
- KASH 2011 [Microsoft Word - KASH 2011-2013 SHQIP 27.08 2010.doc \(rks-gov.net\)](#) fq. 36
- KASH 2013 (2014-2016) [Microsoft Word - Shqip_KASH-i 2014-2016 .docx \(rks-gov.net\)](#) fq. 82
- KASH 2019 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/A207050E-6E64-4A64-81FE-E9B1B2D6799B.pdf> fq 63
- KASH 2023 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/B914D8CF-6E32-4074-A306-456E77A0457A.pdf> fq. 73
- Po ashtu Statistikat e arsimit 2011, 2013, 2016, 2019, 2023
- <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/arsimi>

